



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit me karakter Profesional në:**

**“Asistent Menaxher”**

**Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. Jonida TETA**

**Prof. Asoc. Dr. Elida LIKO**

**Shkurt / 2022**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Diplomë Profesionale në: “Asistent Menaxher”**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në: “Asistent Menaxher”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 370, datë 05.07. 2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 66, datë 09.04. 2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	19 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	174 studentë *
19	Komente / të tjera:	-

\* Numri i studentëve është për katër vite akademike, dy cikle studimi

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës është Institucion i Arsimit të Lartë Publik, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr.5, datë, 07.01.1992, mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor (ILB), themeluar në vitin 1971 me emrin “Universiteti Politeknik i Korçës”. Emri zyrtar këtij universiteti “Fan S. Noli” i është dhënë në vitin 1994, me vendim të Këshillit të Ministrave. Universiteti “Fan S. Noli” përbëhet nga katër njësi kryesore:

1. Fakulteti i Bujqësisë;
2. Fakulteti i Edukimit dhe Fologjisë;
3. Fakulteti i Ekonomisë;
4. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane;

Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Menaxher” është hapur në bazë të Urdhërit Nr. 370, datë 05.07.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Univeristeti “Fan S. Noli”, Korçë. Ky program studimi profesional është i organizuar në dy vite akademike me 120 ECTS (me kohë të plotë, në gjuhën shqipe), sipas Sistemit të Arsimit të Formimit Profesional, nivelit të pestë të Kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve. Njësia përgjegjëse për zhvillimin dhe monitorimin e këtij program studimi profesional është Departamenti i Menaxhimit, i cili është një prej tre njësive përbërëse të Fakultetit të Ekonomisë.

Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga:

1. Departamenti i Financë -Kontabilitetit;
2. Departamenti i Menaxhimit;
3. Departamenti i Marketing –Turizmit;

Pedagogët e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, kontribuojnë në programin e studimit “Asistent Menaxher” në lëndët “Matematikë diskrete”, “Statistikë”, “Hyrje në informatikë”, ndërsa pedagogët e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, kontribuojnë në mësimdhënien e lëndëve si “Sociologji/Psikologji”, “Gjuhë e huaj”. Rreth 83% e stafi akademik, që jep mësim në këtë program studimi është me kohë të plotë.

Diploma profesionale në “Asistent Menaxher” është ndërtuar me qëllim plotësimin e nevojave të tregut rajonal të punës për profesionistë të kualifikuar asistentë menaxher. Programi i studimit synon që studentët të fitojnë njohuri teorike dhe kompetanca profesionale që do t’i ndihmojë ata në realizimin e disa detyrave menaxheriale, të tilla si mbikqyrja e punës, drejtimi dhe motivimi i punonjësve, trajnimin e punonjësve, marrja me ankesat e punonjësve dhe klientë të pakënaqur.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Universiteti “Fan S. Noli” ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Diplomë Profesionale në "Asistent Menaxher", nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL. Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, për programin e studimit me karakter profesional “Asistent Menaxher”.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. As. Dr. Jonida Teta dhe Prof. As. Dr. Elida Liko. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Vizita në Universitetin “Fan S. Noli”, u realizua në datën 8 dhe 9 Nëntor, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore etj. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.01.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 4 / 4 Prot, datë 31.01.2022. Universiteti "Fan S. Noli", Korçë”, përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 145/3 Prot, datë 03.02.2022, “Kthim përgjigje, për draft raportin e vlerësimit të jashtëm”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin I.1 Kriteri 6, Standardin V.2 Kriteri 2, Standardin V.3 Kriteri 1 dhe 3, Standardin V.5 Kriteri 4**, lidhur me të dhënat mbi punësimin e studentëve të diplomuar të programit të studimit.


Institucioni sqaron se ky program studimi është çelur në vitin 2018 dhe diplomimi i brezit të parë përkoi me situatën e vështirë të krijuar nga pandemia, sidomos në pjesën e punësimit, për këtë arsye nuk ka pasur të dhëna për punësimin e studentëve.

**Argumenti i GVJ:** Përsa i përket komenteve nga Universiteti i Korçës, numri zero i të punësuarve tregon mospërputhje midis arsimit dhe nevojave të tregut të punës. **Raporti në këto pika nuk ndryshon.**

2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.5 kriteri 2**, lidhur me përfshirjen në programin e studimit të lëndës “Kulturë e Gjuhës Shqipe”.

Institucioni sqaron se gjatë hartimit të kurrikulës së programit të studimit, departamenti i Menaxhimit, i ka vlerësuar të plota dijet që ofron kjo lëndë, në ciklet para universitare të edukimit.

**Argumenti i GVJ:** Përsa i përket komenteve nga Universiteti i Korçës. shqyrtimi i dokumentave zyrtare tregon mangësi të theksuara të gjuhës shqipe, për të gjithë studentët e diplomuar në të gjitha programet (përfshi edhe studentët ekselent). **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Asistent Menaxher”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit Diplomë Profesionale në “Asistent Menaxher”, është organizuar në përputhje me parashikimet e nenit 72 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi është në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Fan S. Noli”. Në nenin 2 dhe 3, të Statutit të ndryshuar, synohet të jepet një kontribut i rëndësishëm në zhvillimin arsimor, ekonomik me anë të ofrimit të programeve, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, për të kontribuar në zhvillimin rajonal dhe më gjerë. Tregu rajonal i punës ka mungesë për specialistë në fushën “Asistent Menaxher”, që synohet të plotësohet me këtë program studimi. Në planin strategjik të zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë, prioritare është përcaktuar përgatitja e profesionistëve të ardhshëm të suksesshëm që do të punojnë në një mjedis që ndryshon shpejt.</p> <p><i>Aneksi 1.1.1: Draft Statuti i ndryshuar i Universitetit “Fan S. Noli”</i></p> <p><i>Aneksi 1.3: Plani strategjik UNIKO 2016 -2020</i></p> <p><i>Aneks 1.19: Plani i zhvillimit FE 2016 -2020</i></p> <p><i>Aneksi 1.2: Rregullorja e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Menaxher”, është organizuar referuar nivelit 5 të Kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve. Programi i studimit është 2 vjeçar (me kohë të plotë, në gjuhën shqipe) me 120 ECTS. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, konstatohet se Statuti dhe Rregullorja e programit të studimit, kanë të përcaktuar qartë drejtimet prioritare akademike. Programi i studimit ofrohet për të përmbushur nevojat e tregut rajonal të punës, për asistentë menaxherë. Bazuar në emrin e vetë</p>

	<p>programit, asistentent menaxheri do të ndihmojë menaxherin në realizimin e disa detyrave menaxherjale.</p> <p><i>Aneksi 1.1.1: Draft Statuti i ndryshuar i Universitetit "Fan Noli"</i></p> <p><i>Aneksi 1.2: Rregullorja e UK</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional "Asistent Menaxher" ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Menaxhimit, Univesiteti "Fan S. Noli", Korçë. Programi i studimit, është në përputhje me drejtimet akademike të studimit të Univesitetit "Fan S. Noli". Programi synon edukim profesional mbështetur mbi njohuri teorike dhe paktike me qëllim që të përgatisë "Asistent Menaxher" që do kenë një rol të ulët/ të mesëm menaxheri, që do t'i raportojnë menaxherit.</p> <p><i>Aneksi 1.27: Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Aneksi 1.41: Rregullore e brendshme e departamentit të menaxhimit</i></p> <p><i>Aneksi 1.19: Plani i zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Aneksi 1.44: Rregullorja e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Para ofrimit të programit të studimit "Asistent Menaxher", në vitin 2018, është bërë studim tregu bazuar në pyetësorë. Të anketuar janë maturantët (studentët potencialë) dhe biznese të qarkut të Korçës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Maturantët janë intervistuar, me qëllim vlerësimin e interesit për këtë program studimi. Anketimi është shtrirë në shkollat e mesme dhe profesionale të qarkut të Korçës;</li> <li>- Bizneset e qarkut të Korçës janë intervistuar, me qëllim vlerësimin e nevojave të tregut të punës për asistentë menaxherë;</li> </ul> <p>Nga studimi i tregut rezultoi se, gati gjysma e bizneseve shfaqën interes për këtë profesion. Bazuar në mjedisin konkurrues ku bizneset operojnë dhe zhvillimin e madh të teknologjisë, roli i asistent menaxherit në kompani, konsiderohet i nevojshëm për të lehtësuar punën e menaxherëve. Ky program studimi ka rezultuar shumë i kërkuar nga studentët që mbarojnë shkollën e mesme. Hapja e këtij programi studimi, justifikohet me plotësimin e kërkesave të tregut rajonal të punës me profesionistë të kualifikuar si asistent menaxher. Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i administruar konstatojmë se, të</p>

	<p>gjitha kuatat e këtij programi studimi që nga viti akademik 2018 -2019, kur programi i studimit është hapur për herë të parë, dhe në vijim janë plotësuar.</p> <p><i>Aneks 1.45: Studime tregu</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Në këtë program studimi ka gjithsej 38 të diplomuar, nga të cilët 15 të diplomuar për vitin akademik 2019 -2020 dhe 23 të diplomuar për vitin akademik 2020 -2021. Nga dokumentacioni i administruar dhe nga vizita në institucion, konkludojmë se nuk janë zhvilluar studime periodike mbi tregun e punës. Nuk janë raportuar të dhëna për punësimin e studentëve të diplomuar. Në lidhje me problematikat e programit të studimit “Asistent Menaxher”, në vitin 2021, është hartuar një relacion bazuar në pyetësorët online. Nga anketimi rezultoi se 2/3 e studentëve ishin të kënaqur me zgjedhjen që kishin bërë lishur me profilin mësimor.</p> <p><i><u>GVJ rekomandon</u> që të zhvillohen studime periodike të tregut të punës dhe të krijohet një bazë të dhënash për punësimin e studentëve të diplomuar.</i></p> <p><i>Aneks 1.45: Studime tregu</i></p> <p><i>Ankes 35: Tabela përmbledhëse, (tabela nr.23)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Programi i studimit “Asistent Menaxher”, ka për qëllimin plotësimin e kërkesave të tregut të punës të qarkut të Korçës me specialistë të kësaj fushe. Studimi i tregut për “Asistent Manaxher”, është bazuar në anketimin e 250 bizneseve të qarkut të Korçës. Bazuar në 12 pyetje janë testuar tre dimensionet, çështje që shkaktonin situata stresante tek profesionistët, çështje që lidhen me efektivitetin e punës dhe çështje që kishin të bënin me menaxhimin e informacionit. Fakultetit të Ekonomisë, organizon javën e sipërmarrjes në ambjentet e tij, me qëllim që studentët të njihen nga afër me kërkesat dhe kompetencat që kërkohen nga bizneset në veprimtari në rajonin e Korçës. Qendra e Karrierës dhe Alumnit, bën trajnime për studentët për zhvillimin e aftësive të tyre, duke ofruar dhe mbështetje për aplikime. <i>Nuk ka të dhëna për punësimin e studentëve të diplomuar për “Asistent Menaxher”.</i></p> <p><i>Aneksi 1.45: Studime tregu</i></p> <p><i>Aneksi 1.47: Java e sipërmarrjes</i></p> <p><i>Aneksi 1.46: Analiza e veprimtarisë së qendrës së karrierës dhe</i></p>



	alumnit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit “Asistent Menaxher”, ka bashkëpunim dhe ndarje detyra brenda institucionit ndërmjet Departamentit të Menaxhimit si njësi bazë kërkimore shkencore që administron veprimtarinë mësimore dhe Fakultetit të Ekonomisë, si njësi kryesore, me stukturat ndihmës akademike mbështetëse, kontrollin e brendshëm të cilësisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bazuar në (pikën 1, neni 7, të Statutit), Fakulteti është njësia kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe ofron programe studimi të cikleve të ndryshme.</li> <li>- Bazuar në (nenin 8 të Statutit), njësia bazë kërkimore shkencore është Departamenti, i cili administron veprimtarinë mësimore, veprimtarinë kërkimore botuese;</li> </ul> <p>Programi i studimit ka koordinator, në zbatim të VKM nr. 531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”. Bashkëpunimi midis stafit akademik si brenda dhe jashtë departamentit u konstatua edhe gjatë takimit me stafin akademik nga vizita në institucion. Departamenti i Menaxhimit, harton raporte vjetore për ecurinë e procesit mësimor dhe kërkimor, në zbatim të nenit 32, pika 1, të ligjit nr. 80/2015. Në raport ka konstatime të problemeve, gjatë vitit akademik si dhe masat që do të ndërmerren për zgjidhjen e tyre.</p> <p><i>Aneksi 1.1.1: Draft statuti i ndryshuar i Univesitetit „Fan S. Noli“</i></p> <p><i>Aneksi 1.2: Rregullore kërkimore shkencore e Univesitetit</i></p>

	<p><i>Aneksi I. 27: Rregullore e brendshme e fakultetit të ekonomisë</i></p> <p><i>Aneksi III.02: Raportet vjetore të veprimtarisë së Departamentit të Manaxhimit</i></p> <p><i>Aneksi II.09: Koordinator i programit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënësit vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Univesiteti “Fan S. Noli”, për periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2021 ka nënshkruar 46 marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institucione të tjera. Fakulteti i Ekonomisë, Univesiteti “Fan S. Noli”, ka nënshkruar 11 marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institucione shtetërore që ushtrojnë aktivitet në qarkun e Korçës, si banka, hoteleri, supermarkete etj. Pranë këtyre institucioneve studentët e programit të studimit “Asistent Manaxher”, kanë realizuar praktikën profesionale për vitet akademike 2019 -2020 dhe 2020 -2021.</p> <p><i>Aneksi II.14: Pedagogët udhëheqës praktika profesionale</i></p> <p><i>Aneksi I.35: Marrëveshje institucionale</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Krahas raportit vjetor të punës të Fakultetit të Ekonomisë ku analizohen përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, në lidhje me realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve publike dhe private që Fakulteti i Ekonomisë ka nënshkruar marrëveshje, hartohet relacioni i praktikës. Në relacion e praktikës analizohen aftësitë dhe kompetencat e fituara gjatë kursit, në lidhje me kërkesat e tregut rajonal të punës për këtë profesion.</p> <p><i>Aneksi I.37: Relacione praktika</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Studentët e këtij programi, bazuar në Rregulloren e praktikës profesionale, kryejnë praktikë profesionale në vitin e dytë, semestrin e dytë, 125 orë mësimore ose 5 ECTS. Praktika realizohet në institucionet me të cilat Fakulteti Ekonomik ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Praktika mësimore pranë institucioneve shtetërore dhe private realizohet në drejtimin e një stafi të përcaktuar nga departamenti. Pedagogë udhëheqës për realizimin e praktikës profesionale, janë të përcaktuar bazuar në Rregulloren e programit të studimit “Asistent Menaxher”. Në fund të praktikës plotësohet “Formulari i Vlerësimit të studentit praktikant”, nga pedagogu mbikëqyrës dhe nga mbikëqyrësi i praktikës në institucion/kompani.</p> <p><i>Aneksi II.14: Pedagogët udhëheqës praktika profesionale</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumnit, gjatë gjithë vitit</p>

të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	akademik ka në programin e saj takime me biznese, organizata, për bashkëpunime, ofron asistencë për realizimin e aplikimit të studentëve në një program bashkëpunimi, asistencë për kërkimin e një vendi pune, trajnime etj. Për çdo vit akademik bëhet një analizë e			
	<i>Aneks V.03: QKA – kalendari i veprimtarive</i> <i>Aneks I.46: Analiza e veprimtarisë e QKA -së</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi I.3

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Struktura dhe përmbajtja e programit “Asistent Menaxher”, është në përputhje me ligjin nr. 80/2015, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Programi është organizuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, programi i studimit “Asistent Manaxher”, ka në total 120 kredite (ECTS), është me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, me kohë zgjatje 2 vite akademike, i shtrirë në 4 semestra, me 15 javë mësimore çdo semestër. Programi është i organizuar në lëndë/ module, i vlerësuar në kredite. Përfitim i njohurive realizohen me anë të 20 lëndëve të shtrira në dy vite akademike, 11 lëndë në vitin e parë akademik dhe 9 lëndë në vitin e dytë akademik, pa përfshirë praktikën profesionale dhe diplomën.  <i>Aneks I.24: Kurikula e programit të studimit</i> <i>Aneks II.01: Plani mësimor i programit të studimit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	Mbështetur në njohuritë profesionale teorike dhe praktike, programi me karakter profesional “Asistent Menaxher”, synon lehtësimin e aspekteve të menaxhimit. Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi është hartuar stuktura kurrikulare e programit, në përputhje me Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, e ndryshuar.  Asistent menaxheri drejton dhe koordinon shërbime

	<p>praktike dhe administrative si, mbajtja e informacionit, përgatitja e raporteve, menaxhimi dhe përgatitja e korespondencës, organizimi i takimeve etj. Për këtë qëllim në programin e studimit janë përfshirë lëndë si “Organizimi i informacionit dhe të dhënave”, “E –business dhe komunikimi elektronik”, “Aftësi komunikuese”, “Programe të përpunimit të fjalës dhe prezantimit”. Bazuar në kompetencat dhe aftësitë e fituara gjatë kursit, programi i studimit “Asistent Menaxher” ofron mundësi punësimi të ndryshme si: Asistent menaxher, asistent administrative, asistent personal, asistent marketing, sekretar ekzekutiv etj.</p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit përbëhet nga lëndë që i pajisin studentët me aftësitë e nevojshme, për të kryer mirë funksionin e asistent menaxherit. Jo vetëm lëndët karakterizuese të programit të studimit por edhe ato ndërdisiplinore që përfshijnë lëndë të tilla si “Sociologji”, “Psikologji”, “Marrëdhënie me konsumtorin”, janë shumë të rëndësishme dhe i japin një avantazh në vendin e punës, pasi ndihmojnë në marrëdhëniet e asistent menaxherit me të punësuarit e kompanisë dhe klientët, ndihmojnë në zgjidhjen e situatave në vendin e punës. Në përfundim të programit të studimit, studentët janë të pajisur me një sërë aftësish si për shembull, aftësi profesionale, aftësi për të vlerësuar, aftësi komunikimi dhe aftësi e të mësuarit, që ju krijon atyre mundësi të zgjidhin në mënyrë profesionale dhe situata të vështira si dhe të përdorin dijet e fituara për të trajnuar stafin e niveleve më të ulta. Gjatë realizimit të praktikës profesionale, studentët kanë mundësi të testojnë të gjithë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë programit të studimit dhe gjetjen e zgjidhjes të problemeve praktike me ndihmën e profesorit tutor të praktikës.</p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Programi është ndërtuar bazuar në kërkesën e tregut rajonal të punës, në Korçë për profesionin e “Asistentit Menaxherit”. Në funksion të aftësive dhe kompetencave të kërkuara nga tregu i punës, është ndërtuar kurrikula e programit. Gjatë programit profesional dy vjeçar zhvillohen aftësi që një asistent menaxher duhet të ketë me qëllim që të kryej me sukses të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që i ngarkohen nga menaxheri.</p> <p>Gjatë këtij programi zhvillohen aftësi të mira si:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komunikuese;</li> <li>- Planifikuese;</li> <li>- Marketingu;</li> <li>- Shërbimi me klientin.</li> </ul> <p>I gjithë programi i studimit është në funksion të trajtimit të problemeve në vendin e punës, të gjetjes së zgjidhjeve për problemet dhe aftësimin e “asistent menaxherit” që të zëvendësojë menaxherin kur mungon.</p> <p><i>Aneksi 1.46: Analiza e veprimtarisë e QKA</i></p> <p><i>Aneksi 1.24: Kurrikula e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneksi 1.25: Programet lëndore</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Universiteti “Fan S. Noli” përmbush kriteret e përcaktuara në pikën nr. 2, nenin 20, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Universiteti “Fan S. Noli”, është i përbërë nga katër fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakulteti i Bujqësisë;</li> <li>2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë;</li> <li>3. Fakulteti Ekonomik;</li> <li>4. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane;</li> </ol> <p>Fakulteti i Bujqësisë dhe Fakulteti Ekonomik kanë 3 departamente (njësi bazë), ndërsa Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane kanë katër departamente.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë ka tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Financë –Kontabilitetit;</li> <li>2. Departamenti i Menaxhimit;</li> <li>3. Departamenti i Marketing –Turizmit;</li> </ol> <p>duke potësuar kriteret e vendosura nga neni 23, pika 2 e ligjit nr. 80/2015.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB feko.docx</i>), Fakulteti i Ekonomisë në vitin akademik 2020-2021, ka në përbërje të tij <b>36 pedagogë gjithsej</b>, ndër të cilët, <b>34</b> janë staf akademik efektiv ( PAE), ndër të cilët 14 me gradën shkencore “Prof. Asoc. Dr”, 15 me gradën shkencore “Doktor” dhe 5 “Msc”. dhe <b>2</b> staf akademik me kontratë, (PAK), ndër të cilët 1 me gradën</p>

shkencore “Dr”, dhe 1 me Msc.

Pedagogët e Departamentit të Menaxhimit, janë të angazhuar në mësimdhënien e tre lëndëve, në përputhje me fushën e tyre të studimit, me përjashtim të një pedagogu që është i angazhuar në katër lëndë. Departamenti i Menaxhimit, që ofron këtë program studimi, përmbush kërkesat ligjore, të specifikuara në nenin 25, pika 4, e ligjit nr. 80/2015.

Referuar dokumentit (*tabela permbledhese\_rvb-uk\_prog\_studimi\_as. menaxher.pdfpersoneli, tab 2.1 dhe 2.2*) Akademik i Departamentit të Menaxhimit për dy vitet e fundit përbëhet nga:

Gradat/Titujt/	2020-2021		2021-2022	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-
Prof.Assoc	4	-	4	-
Dr	5	-	5	-
MSc	1	2	1	2
	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>10</b>	<b>2</b>
<b>Total</b>	<b>12</b>		<b>12</b>	

Për sa i përket kualifikimeve të PA të Departamentit të Menaxhimit :

- Për 2020-2021, 75% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 25% janë Msc;
- Për 2021-2022, 75% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 25% janë Msc;

Bazuar në CV e sfatit akademik, konkludojmë se stafi akademik është i motivuar, i angazhuar në kualifikim të vazhdueshëm, ka pjesëmarrje në aktivitete shkencore dhe botime në përputhje me fushën e tij të ekspertizës.

*Aneks I. 31: Personeli akademik FE*

*Aneksi I. 32: Personeli akademik DM*

*Aneksi I.33: Personeli akademik programi i studimit*

*Ankesi: II.10: CV Stafi akademik*

(*tabela permbledhese\_rvb-uk\_prog\_studimi\_as. menaxher.pdfpersoneli, tab 2.1 dhe 2.2*)

**Kriteri 6.** Programet e studimeve

Në Rregulloren e programit të studimit, janë të përcaktuara

kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	qartë objektivat formuese të programit të studimit, njohuritë dhe kompetencat që studentët do të fitojnë. Programi i aftëson studentët për menaxhimin e performancës të stafit, menaxhimin e konfliktit, menaxhimin e projekteve dhe menaxhimin e buxhetit. Me qëllim përbushjen e objektivave, është hartuar programi i studimit, sipas përcatimeve të Vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar. Kompetencat e përfituara në këtë program studimi përcaktohen në suplementin e diplomës.  <i>Aneksi 1.44: Rregullore e programit të studimit</i> <i>Aneksi II.07: Modeli i diplmës dhe suplementit</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënies, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni konfirmohet që programi i studimit Diplomë Profesionale në: “Asistent Menaxher”, përputhet plotësisht me kriteret e caktuara dhe aktet nënligjore në fuqi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve. Programi i studimit është 2 vjeçar (me kohë të plotë, në gjuhën shqipe) me 120 ECTS. Programi është ndërtuar bazuar në kërkesën tregut rajonal të punës, në Korçë për profesionin e “Asistentit menaxherit”. Në funksion të aftësive dhe kompetencave të kërkuara nga tregu i punës, është ndërtuar kurrikula e programit. Gjatë programit profesional dy vjeçar zhvillohen aftësi që një asistent menaxher duhet të ketë me qëllim që të kryej me sukses të

	<p>gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që i ngarkohen nga menaxheri.</p> <p><i>Aneksi 1.44: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Menaxher”, është organizuar referuar nivelit 5 të Kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve. Programi i studimit është 2 vjeçar (me kohë të plotë, në gjuhën shqipe) me 120 ECTS. Struktura dhe përmbajtja e programit “Asistent Menaxher”, është në përputhje me ligjin nr. 80/2015, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Programi është organizuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, programi i studimit DP në “Asistent Manaxher”, ka në total 120 kredite (ECTS), është me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, me kohë zgjatje 2 vite akademike, i shtirë në 4 semestra, me 15 javë mësimore çdo semestër. Programi është i organizuar në lëndë/ module, i vlerësuar në kredite.</p> <p>Përfitimi i njohurive realizohen me anë të 20 lëndëve të shtrira në dy vite akademike;</p> <p>11 lëndë në vitin e parë akademik;</p> <p>9 lëndë në vitin e dytë akademik;</p> <p>pa përfshirë praktikën profesionale dhe diplomën.</p> <p>Plani mësimor i këtij programi studimi është i hartuar sipas ligjit për arsimin e lartë 80/2015 si dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018. Plani mësimor është i organizuar me 120 kredite. Për të shlyer detyrimet e një viti studimi, studenti duhet të marrë 60 kredite në vit. Bazuar në planin mësimor të vënë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 15 % (ose 16 Kredite) janë Lëndë Bazë;</li> <li>- 55% (ose 64 Kredite) janë Lëndë karakterizuese;</li> <li>- 15% (ose 16 Kredite) janë Lëndë ndërdisiplinore/integruese;</li> <li>- 15% (ose 18 Kredite) janë Lëndë plotësuese;</li> <li>- 5% (ose 6 Kredite) janë Detyrime përmblylëse;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Syllabuset e paraqitura për këtë program studimi japin një informacion të detajuar në lidhje me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit, ndjekjen e lëndës, rregullat e auditorit, institucionit, etj. Praktika mësimore dhe ajo</p>



	<p>profesionale janë gjithashtu të prezantuara me anë të një syllabusi i cili sqaron detyrimet e studentit për përmbushjen e praktikës.</p> <p><i>Aneks I.24: Kurikula e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks I.25: Programet lendore</i></p> <p><i>Aneks II.01: Plani mësimor i programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Syllabuset e paraqitura për këtë program studimi japin një informacion të detajuar në lidhje me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit, ndjekjen e lëndës, rregullat e auditorit, institucionit, etj. Praktika mësimore dhe ajo profesionale janë gjithashtu të prezantuara me anë të një syllabusi i cili sqaron detyrimet e studentit për përmbushjen e praktikës.</p> <p><i>Aneks I.24: Kurikula e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks II.01: Plani mësimor i programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshëm fleksibel për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Struktura e programit të studimit përmban një listë lëndësh me zgjedhje të cilat janë pjesë e kurrikulës me qëllim që të ofrojnë fleksibilitet në formimin e studentëve. Në të njëjtën kohë, nga takimi me studentët dhe lektorët rezultojnë se disa lëndë janë të vështira për studentët duke patur parasysh mesataren e tyre në hyrje. Gjithashtu vërehet se në planin mësimor ka një grup lëndësh të cilat i japin atyre dijet e mjaftueshme për të performuar në tregun e punës. Lëndët bazë në këtë program studimi janë në përputhje me strategjinë e programit dhe objektivat e tij dhe duke patur këto lëndë bazë studenti është në gjendje të krijojë një kornizë të qartë mbi studimet që po ndjek. Gjithashtu lëndet ndërdisiplinore si “Sociologji”, “Psikologji”, “Marrëdhënie me konsumtorin”, janë shumë të rëndësishme dhe i japin një avantazh studentëve në vendin e punës.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Praktika mësimore zhvillohet semestrin e dytë të vitit të dytë. Praktika profesionale (5 ETC) zhvillohet në përfundim të studimeve. Kjo praktikë zhvillohet nën mentorimin e profesorëve dhe të institucionit ku zhvillohet praktika. Në fund profesori udhëheqës e vlerëson studentin bazuar në dokumentacionin që studenti dorëzon. Gjatë realizimit të praktikës profesionale, studentët kanë mundësi të testojnë të gjithë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë programit të studimit dhe gjetjen e zgjidhjes të problemeve praktike me ndihmën e</p>

	profesorit tutor të praktikës. <i>Aneksi I.37: Relacione praktika</i> <i>Aneksi I.39: Udhezues praktika</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


## Standardi II.2

**Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Menaxher”, është organizuar referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit është 2 vjeçar (me kohë të plotë, në gjuhën shqipe) me 120 ECTS. Struktura dhe përmbajtja e programit “Asistent Menaxher”, është në përputhje me ligjin nr. 80/2015, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Programi është organizuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Kjo shpërndarje mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Orët në auditor dhe jashtë tij i japin studentit informacionin e nevojshëm formimin e tij dhe përgatitjen për tregun e punës. Gjatë vizitës së tij GVJ vuri në dukje se një pjesë e madhe e lëndëve të planit mësimor janë me karakter ekonomik të përgjithshëm, dhe pjesa tjetër ka karakter profesional.  <i>Aneksi I.24: Kurrikula e programit të studimit</i> <i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i>
<b>Kriteri 3.</b> Planit mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Planit mësimor si dhe materialet mbështetëse të tij (syllabuset) japin informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e lëndës, syllabuset janë shumë të qarta në lidhje me orët që zhvillohen në auditor. Syllabuset, kreditet, orët mësimore në auditor dhe orët e studimit individual janë në përputhje me planin mësimor.
<b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit	VKM nr.41 datë 24.01.2018 e ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019, parashikon se duhet të ketë një


<p>teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik kundrejt atyre praktik, si dhe 25% të programit duhet t'i dedikohet aftësimin në profesion.</p> <p>Programi studimit ka në total 1500 orë në vitin e parë të studimit, nga të cilat 660 orë zhvillohen në auditor dhe 840 orë jashtë auditorit. Në vitin e dytë të studimit në total janë 1500 orë nga të cilat 540 orë në auditor dhe 960 orë jashtë auditorit. Për të dy vitet akademike, orët jashtë auditorit zënë respektivisht 56% dhe 64% të totalit të orëve;</p> <p>Programi ka për dy vite akademike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- orë totale në auditor 1158;</li> <li>- 657 orë leksione;</li> <li>- 501 orë seminare;</li> <li>- 125 orë praktika profesionale;</li> <li>- 150 orë diploma;</li> </ul> <p>Raporti i formimit teorik dhe atij praktik, është 50:50. Aftësimi professional dhe praktika zënë rreth <b>52.3 % të totalit të orëve, në dy vite akademike.</b></p> <p>Në këtë program studimi ka një raport pothuajse të balancuar midis moduleve /aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga ana e strukturimit të kurrikulës dhe planit mësimor, ndarjes në kredite dhe orë mësimore programi i studimit mundëson arritjen e objektivave formuese. Për sa i përket përbajtjes së planit mësimor në lëndë, programi ka si qëllim nxitjen e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës. Gjatë takimit me NJSBC-në, GVJ vuri në dukje rëndësinë e hartimit të planit mësimor në bashkëpunim me bizneset dhe studentët, gjë kjo e cila do të krijonte mundësinë për një plan mësimor që i vjen në ndihmë studentëve dhe bizneseve të interesuar për të patur punonjës në këtë fushë studimi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Standardi II.3**



**Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Asistent Menaxher”, përmban të dhëna të plota mbi formimin teorik dhe praktik të studentëve. Studentit i vihet në dispozicion plani mësimor si dhe syllabuset për çdo lëndë të ndjekur gjatë periudhës së formimit të tij. Gjatë takimeve të realizuara GVJ ju vu në vëmendje se studenti në momentin e regjistrimit ka në dispozicion planin mësimor që do të ndjekë. Ndërsa syllabuset i vihen në dispozicion në fillim të cdo lënde, kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët.</p> <p><i>Aneksi I.24: Kurrikula e programit të studimit</i> <i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Programi i studimit ka një përmbajtje më së shumti ekonomike me qasje profesionale në fushën e studimit, gjë kjo e cila u vu në dukje nga GVJ edhe gjatë takimeve të zhvilluara në IAL. Hapja e programit të studimit është realizuar duke u mbështetur në një kërkim tregu të përgjithshëm dhe plani mësimor është hartuar në bashkëpunim me bizneset e fushës profesionale. GVJ mendon se është e qartë pritshmëria e bizneseve në kete rajon dhe përmbushja e tyre nga ana e studentëve. Duke qenë ky program studimi është relativisht i ri , GVJ nuk mund të gjykojë në lidhje me aftësimin e këtyre studentëve nga ky program studimi dhe nëse nevojat e bizneseve plotësohen nga ky profil studentësh etj. Kjo do të mbetet të vlerësohet në vazhdim dhe do të shërbejë për të përmirësuar programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në syllabuset e vëna në dispozicion përmbajtja e lëndëve me karakter profesional i vjen në ndihmë studentëve për formimin e tyre. Lëndët në kurrikul kanë një shpërndarje e cila mundëson zhvillimin e aftësive të transferueshme nga njëra lëndë në tjetrën. Vazhdimësia e lëndëve në kurrikul mundëson përdorimin e dijeve përgjatë viteve akademike që student ndjek në programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim e</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL dhe takimeve të zhvilluara, sidomos në takimin me studentët, evidentohet rëndësia e kryerjes së praktikës mësimore dhe asaj profesionale. Studentët e</p>




njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	shikojnë mundësinë e praktikës si një mënyrë të mirë për të vënë në jetë dijet e tyre.  Një pjesë e studentëve kanë zgjedhur këtë program studimi duke qënë se janë të angazhuar në fushën e menaxhimit. Por një pjesë tjetër e tyre nuk janë të angazhuar në këtë fushë dhe kanë pritshmëri më të larta për zhvillimin e praktikës dhe krijimin e mundësive të punësimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Studentët në këtë program studimi gjatë zhvillimit të praktikës janë në kontakt të vazhdueshëm me mentorin e praktikës si nga ana e departamentit dhe nga kompania ku zhvillohet praktika. Deri më tani studentët i kanë krijuar mundësitë e praktikës më së shumti bazuar në njohjet e tyre personale dhe nga gama e bizneseve të ofruara nga IAL-ja për zhvillimin e praktikës mësimore dhe profesionale.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikatat më të mira të fushës</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngrre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen	Me qëllim kontrollin e brendshëm të cilësisë, sipas specifikimeve të nenit 103, të ligjit nr. 80/2015, Universitetit “Fan S. Noli”, ka ngritur rrjetin për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të përbërë nga Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, i ngritur brenda Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, sipas përcaktimeve të pikës 2, neni 84 të Statutit. Brenda këtij sektori funksionon NJSBC -ja, me përfaqësues një koordinator nga çdo njësi kryesore.

publike.	<p>Vlerësimi i brendshëm i ciësisë menaxhohet nga NJSBC - ja. Ajo ka si qëllim kryesor të monitorojë veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në universitet. NJSBC –ja përbëhet nga 6 anëtarë, 4 përfaqësues të personelit akademik, 1 student dhe një ekspert i jashtëm. Vlerësimi i programeve të studimit organizohet si rregull një herë në vit. Vlerësimi mbështetet në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhe, në pyetësorë dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin ndihmës mësimor, administrativ dhe studentët. Universiteti “Fan S. Noli”, ka hatuar një manual për cilësinë e Universitetit, i cili përfshin proceset e ndërmarra nga institucioni për sigurimin e cilësisë. Departamenti harton raporte vjetore. Pjesë e rëndësishme e këtyre raporteve është procesi mësimor dhe kërkimi shkencor. Në raport bëhen jo vetëm konstatime të problematikave të ndryshme por parqiten edhe masat që do të ndërmerren për zgjidhjen e tyre. Rezultat e studimeve janë bërë publike dhe janë diskutuar nga drejtuesit e njësive të vlerësuara.</p> <p><i>Aneks: 1.1.1. Draft statuti i ndryshuar</i></p> <p><i>Aneks 1.5: Rregullorja e Drejtorisë së Kurikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor</i></p> <p><i>Aneks 1.16: Manuali i cilësisë UNIKO</i></p> <p><i>Aneks III.02: Raporte vjetore të veprimtarisë të Departamentit të Menaxhimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Referuar planit mësimor të studimit “Asistent menaxher”, lloji i orëve mësimore që zhvillohet në kuadër të këtij programi është vetëm leksione dhe seminare, nuk ka orë laboratorit të përcaktuara. Në Regulloren e programit të studimit, është përcaktuar se përbërësit e vlerësimit të vazhduar përcaktohen nga secili pedagog në syllabusin e disiplinës. Referuar syllabuseve, vlerësimi i vazhduar gjatë vitit zë 30% të vlerësimit total, ndërsa 70% e zë provimi përfundimtar që zhvillohet me shkrim. Në varësi të syllabusit të lëndës zhvillohen ushtrime praktike, diskutime, raste studimore, ese, detyra të tjera (kuize).</p> <p>Vlerësimi gjatë vitit, përfshin kolegiumin, detyra kursi/projekte, kuize dhe diskutime. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me stafin pedagogjik, është shpjeguar se në varësi të lëndëve specifike të tilla si “Kontabilitet”, “Informatikë”, “Statistikë”, “Eksel” etj, zhvillohen punë</p>



	<p>në laborator.</p> <p><i>GVJ rekomandon që orët e laboratorit që zhvillohen gjatë vitit, në lëndët e sipër cituara, të reflektohen dhe në planin mësimor.</i></p> <p><i>Aneks I.44: Rregullorja e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i></p> <p><i>Aneksi II.01: Plani mësimor</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik, përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, duke përfshirë edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie. Departamenti i Menaxhimit, përgjegjës për këtë program studimi, ka zhvilluar leksione të hapura (në total 11 aktivitete për periudhën 2018 -2021, me përfaqësues të bineseve të qarkut të Korçës), me qëllim rritjen e orëve praktike gjatë vitit akademik, njohjen e studentëve me kërkesat e punëdhënësve për aftësi dhe kompetenca të kërkuara nga tregu i punës.</p> <p><i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i></p> <p><i>Aneks I.28: Leksione të hapura</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e administruar, CV të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, dëshmohet se pedagogët kanë njohuritë e duhura për shpjegimin e lëndëve dhe, janë të angazhuar në kualifikime të vazhdueshme me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përfshirjes së metodave të reja të mësimdhënies dhe rritjes së cilësisë të aktivitetit shkencor. Pedagogët e Departamentit të Menaxhimit, për periudhën 2015-2021, janë angazhuar në botimin e 31 artikujve shkencorë, kanë mbajtur 27 referime në veprimtari shkencore dhe kanë botuar 8 tekste universitare.</p> <p><i>Aneks II.10: CV Stafit akademik</i></p> <p><i>Aneks II.01: Plani mësimor</i></p> <p><i>Aneks IV.07: Aktiviteti kërkimor shkencor DM</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në dokumnetacioin e administruar konstatomë se, niveli i kualifikimeve të stafit akademik të FE ka ardhur në rritje. Numri i anëtarëve të stafit që ka marrë gradën shkencore “Doktor”, nga 10 në vitin 2018 është rritur në 14 në vitin 2019, në 16 në vitin 2021. Sfafi pegagogjik në funksion të këtij program studimi, është i angazhuar në pesë projekte në shkallë fakulteti dhe në dy projekte ndërkombëtare. Pedagogët janë të angazhuar dhe trajnime në kuadër të programeve të ndryshme si për shembull</p>



	INTEREG II, INTREG III, TEMPUS, ERASMUS, Banka Botërore. <i>Aneks IV.08: Kualifikim stafi pedagogjik të FE</i> <i>Aneks II.10: CV Stafi akademik</i> <i>Aneks: Tabela përmbledhëse (tabela 19; 20)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.2

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	<p>Infrastruktura e shfrytëzueshme për këtë program studimi është e mjaftueshme, funksionale dhe cilësore për realizimin e objektivave të këtij program studimi. Universiteti “Fan S. Noli”, ushtron aktivitetin në gjashtë godina universitare që janë pronë e shtetit. Godina e Fakultetit të Ekonomisë, është në rikonstruksion dhe mësimi është zhvendosur në godinën e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, për këtë arsye gjatë vizitës në institucion nuk ishte e mundur kqyrja e auditorëve funksional. Fakulteti i Ekonomisë, ka një sipërfaqe totale të brendshme prej 3170 m<sup>2</sup>, 4 laboratore në total nga të cilët dy janë laboratorë informatike dhe dy laboratorë për lëndët, 15 klasa seminari, 7 klasa leksioni, një sallë interneti, një sallë biblioteke. Ambjente m<sup>2</sup> për studentët janë 2541 dhe m<sup>2</sup> për personelin është 515.</p> <p>Norma e sipërfaqes të shfrytëzueshme për studentët është 2.6 m<sup>2</sup>/student (2608 m<sup>2</sup> :993 studentë), plotëson kriteret ligjore të vendosura, bazuar në aneksin nr. 1 të Vendimin nr. 418, datë 10.05.2017, “Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riongarnizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”. Sipas VKM -së norma e sipërfaqes të shfrytëzueshme për shkencat sociale është përcaktuar 2.5 m<sup>2</sup> për student. Norma e sipërfaqes të shfrytëzueshme për mjediset për stafin është 13.7 m<sup>2</sup>/person (549 m<sup>2</sup>: 40 persona).</p>



	<p><i>Aneksi III.04: Të dhëna për infrastrukturën</i>  <i>Aneks: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 16)</i>  <i>Aneks 1.15: Raport kontrolli i MASR për kapacitetet pritëse</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Universiteti “Fan S. Noli” në kuadër të përfshirjes në Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH), ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në datë 31.03.2016 për aplikim dhe mirëmbajtje të sistemit ESSE3. RASH është një rrjet kombëtar kërkimi dhe edukimi, që ka zhvilluar aplikime “softëare” të ndryshëm si U – Albania, U – Library (library dixhitale), E –Research, U –Doc. e të tjera. Studentët dhe pedagogët kanë akses në bibliotekën online dhe sistemin ESSE3, si platformë komunikimi dhe shkëmbimi informacioni të brendshëm. Për realizimin e procesit mësimor, janë shfrytëzuar platformat online “Moodle”, “Edumeet”, “Goole meet”, “Goole classroom” dhe “Office 365”. Univesiteti “Fan S. Noli”, ka faqen zyrtare <a href="https://moodle.unkorce.rash.al">https://moodle.unkorce.rash.al</a>, nga ku mund të merren informacione për programet e studimit, aktivitete, projekte, botime të institucionit. Faqja zyrtare funksionon në përputhje me politikat e institucioni.</p> <p><i>Aneksi III.05: Marrëveshja midis UK dhe RASH për ESSE3.</i>  <i>Aneksi: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 17)</i>  <i>Aneksi 1.6.1: Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik ESSE3.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Gjuha e programit të studimit është gjuha shqipe, sipas Rregullores së programit të studimit. Bazuar në të dhënat e këtij program studimi, literatura bazë për lëndët e këtij programi është në gjuhën shqipe me përjashtim të gjuhëve së huaja (“Anglish” dhe “Frëngjisht”) dhe lëndës “Mardhënie me publikun”, që e ka literaturën bazë në gjuhën angleze. Për katër nga lëndët që ofrohen në këtë program studimi “E -Business” dhe “Organizimi i Informacionit dhe Baza e të Dhënave”, që janë lëndë karakterizuese punohet me dispenca/ cikël leksioni dhe në dy lëndë me zgjedhje “Marrëdhënie me Konsumatorin” dhe “Planifikimi i Aktiviteteve” punohet me cikël leksioni. Senati akademik i Universitetit “Fan S. Noli”, ka miratuar një Udhëzim mbi procedurat e miratimit, botimit dhe shpërndarjes së teksteve mësimore në nivel njësie bazë, në datë 22.7.2019. Bazuar në këtë Udhëzim, Rektorati lejon botimin e publikimeve në bazë të pëlqimit me shkrim të njësisë bazë, të së paku dy recensuesve të fushës dhe rektorit. Në 68% të lëndëve të programit të</p>

	<p>studimit, literatura ndihmëse është edhe në gjuhën angleze. Gjuha angeze është lëndë plotësuese me detyrim për këtë program studimi, duke rritur mundësinë e shfrytëzimit të materialeve plotësuese.</p> <p><i>Aneksi I.12: Udhëzim mbi procedurat e miratimit, botimit dhe shpërndarjes së teksteve mësimore në nivel njësie bazë.</i></p> <p><i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë ka në dispozicion të studentëve mbi 4833 tituj, në gjuhën shqipe, angleze dhe në gjuhën frënge. Studentët e këtij program studimi, krahas gjuhës angleze zhvillojnë dhe gjuhën frënge, duke patur mundësi të shfrytëzojnë literaturën e ofruar. Studentët dhe stafi akademik kanë në dispozicion bibliotekën dixhitale U –library dhe E –Library. Përdorimi i literaturës online siguron të gjithë materialet e nevojshme për të përvetësuar leksionet, aksesin në artikuj shkencor dhe raste studimore, është nevojshëm për të përgatitur detyrat e kursit, esetë, dhe prezantuar raste studimore, gjatë orëve të seminarit.</p> <p><i>Aneks III.06: Biblioteka</i></p> <p><i>Aneksi III.05: Marrëveshja UK -RASH</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për Fakultetin e Ekonomisë janë në dispozicion dy laboratorë për lëndët me kapacitet 90 studentë, dy laboratorë informatike me kapacitet 70 studentë dhe një sallë për internetin. Bazuar në numrin e studentëve të rregjistruar në këtë program studimi, për vitin akademik 2021-2022 janë 23 studentë, për vitin akademik 2020-2021 janë 41 studentë, konkludojmë se infrastruktura laboratorike në funksion të këtij programi studimi është e plotë. Si pasojë e rikonstruksionit të Fakultetit të Ekonomisë, mësimi po zhvillohet në “Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë”, i cili ka 4 laboratorë dhe në “Fakultetin e Bujqësisë” i cili ka 10 laboratorë.</p> <p><i>Aneks III.04: Të dhëna për infrastrukturën</i></p> <p><i>Aneks: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 21; tabela nr.17)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies studentët kanë portalin e studentit, në këtë portal gjenden materiale studimi (leksione dhe detyra), orari mësimor, vlerësimi i marrë, frekuentimi, informacione për trajnime dhe aktivitete të ndryshme që zhvillohen nga Fakulteti i Ekonomisë. Në kuadër të mësimin online si pasojë e pandemisë Covid - 19, janë shfrytëzuar platformat online Moodle, Edumeet,</p>

	<p>Google meet, Google classroom dhe Office 365 (Teams). Nga vizita në institucion, konstatuam se, studentët nuk kanë pasur vështirësi me mësimin online në kuptimin e materialeve të lëndëve dhe realizimit të projekteve/detyrave të kursit sipas syllabusit.</p> <p><i>Aneks: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 17)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.3

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>Bazuar në Statutin e Universitetit “Fan S. Noli”, rrjeti i cilësisë përbëhet nga sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumnit i ngritur brenda Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional. Brenda këtij sektori funksionon NJSBC –ja. Universiteti “Fan S. Noli”, ka hartuar rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimi të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor (DKSCK). Në përputhje me pikën 3, neni 1, të kësaj Rregullore, DKSCK monitoron cilësinë në programe të ndryshme studimi, mbarëvajtjen e veprimtarisë kërkimore, mbarëvajtjen e procesit të dixhitalizimit të të dhënave për programet e studimit. DKSCK bën koordinimin e mbledhjeve të NJSBC –së, mbështet hartimin e raportit vjetor të vlerësimit të brendshëm. Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, është pjesë e DKSCK –së. Detyrat kryesore të këtij sektori janë të përcaktuara në nenin 6, të Rregullores, ku mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunimin me njësitë bazë të UK –së dhe NJSBC –në;</li> <li>- Monitorimin e cilësisë e zbatimin e kurrikulës në cikle të ndryshme;</li> <li>- Kontrollon ecurinë e procesit mësimor;</li> <li>- Ndjek analizat mësimore pranë Departamenteve dhe</li> </ul>

	<p>Fakulteteve.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit, raporton në mbledhjet e departamentit për çdo çështje që lidhet me programet e studimit. Pedagogët e këtij program studimi, hartojnë një Raport semestral për secilën lëndë, ku evidentohen pikat e forta dhe pikat e dobëta, dhe mundësitë për përmirësime të ardhme.</p> <p><i>Aneks 1.1.1: Draft statuti i ndryshuar</i></p> <p><i>Aneks 1.5: Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Në përputhje me nenin 32, të ligjit nr. 80/2015, Departamenti i Menaxhimit, përgjegjës për këtë program studimi, ka hartuar raporte vjetore të detajuara ku është analizuar ecuria e procesit mësimor dhe kërkimi akademik. Analiza vjetore e departamentit ka nxjerr objektiva për vitin e ardhshëm akademik. Konsiderojmë të rëndësishëm, përfshirjen e studentëve në përmirësimin e programit të studimit, me anë të pyetësorëve që zhvillohen gjatë të dy semestrave dhe synojnë vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Fakulteti i Ekonomisë ka zhvilluar një analizë SWOT, në kuadër të planit të zhvillimit për fakultetin 2016-2020, ku janë evidentuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Ndër prioritet kryesore në planin e zhvillimit është zhvillimi i stafit të fakultetit nëpërmjet pjesëmarrjes në programe të formimit profesional, seminare, trajnime dhe aktivitete të tjera brenda apo jashtë universitetit, krijimi i ekipeve të punës me pjesëmarrje nga departamente të ndryshme, për projekte të përbashkëta.</p> <p><i>Aneks III. 02: Raportet vjetore të veprimtarisë së Departamentit të Menaxhimit</i></p> <p><i>Aneks I.19: Prani i zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Bazuar në pikën 1, neni 16, i Rregullores të FE, personeli i Fakultetit Ekonomik përbëhet nga personel akademik, personel ndihmës akademik dhe personel administrativ. Personeli akademik kryen veprimtarinë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillimin e institucionit, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera. Personeli ndihmës akademik, ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor, dhe personel ndihmës akademik me karakter administrativ, sipas (nenit 23 të Rregullores të FE). Departamenti i</p>

	<p>Manaxhimit, ka personel ndihmës akademik me karakter mësimor, një laborante. Universiteti “Fan S. Noli”, ka hartuar Rregulore për organizimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore. Në nenin 118, të kësaj Rregullore janë përcaktuar veprimtaritë kërkimore të Universitetit, njësitë kryesore për menaxhimin dhe koordinimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore. Personeli akademik përgjegjës për programin e studimit është i angazhuar në trajnime në kuadër të programeve të ndryshme, me qëllim rrijen e cilësisë së mësimdhënies, aplikimit të teknologjisë në mësimdhënie, ilustrimit të teorisë me ushtrime praktike dhe rasteve studimore. Stafi ndihmës akademik është i kualifikuar dhe i trajnuar në përdorimin e sistemit ESSE 3 (system i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve).</p> <p><i>Aneksi 1.2: Rregullorja e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO</i></p> <p><i>Aneksi I.10: CV Stafi akademik</i></p> <p><i>Aneksi II.16: CV Stafi ndihmës akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre.</p>	<p>Në kuadër të teknologjisë së informacionit që përdoret në Universitetin “Fan S. Noli”, sistemi ESSE3 janë organizuar trajnime për përdorimin e sistemit ESSE3, dhe të bibliotekës on line (U -library). Për mësimdhënien online si pasojë e pandemisë Covid -19, janë bërë trajnime për platformat Moodle, EduMeet, Office 365, Google meet dhe google classroom.</p> <p><i>Aneks: Tabela përmbledhëse (tabela nr 17)</i></p> <p><i>Aneks III.05: Marrëveshja UK –RASH</i></p> <p><i>Aneks 1.6.1: Marrëveshje RASH për ESSE3</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Pedagogët për sciën lëndë që zhvillojnë hartojnë relacion të detajuar me ngarkesën mësimore, frekuentimin, kalueshmërinë në provime. NJSBC bën një analizë vjetore të punës, në përputhje me rregulloren e NJSBC, ku raportohet për përmbushjen e objektivave sipas planit vjetor të veprimtarisë kërkimore shkencore. Për çdo vit akademik, Departamenti i Menaxhimit, që ofron këtë program studimi bën një analizë vjetore të punës të kryer nga departamenti, detyrat dhe realizimin e planit vjetor të veprimtarive. Në përfundim të analizës vjetore lihen detyra për vitin e ardhshëm akademik. Objektivat e Departamentit në lidhje me mësimdhënien dhe</p>

	<p>mësimnxënien (si pjesë e raporteve vjetore të veprimtarisë) janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aplikimi i metodave inovative të mësimdhënies;</li> <li>- Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies e vlerësimit të dijeve;</li> <li>- Hartimi i relacioneve vlerësuese të çdo lënde nga titullari i saj;</li> <li>- Pjesëmarrja në projekte për përmirësimin e kurrikulës dhe sigurimi i cilësisë.</li> </ul> <p><i>Aneksi 3.02: Raportet vjetore të veprimtarisë të Departmentit të Menaxhimit</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


#### Standardi III.4

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në (nenin 74 të Rregullores së FE), (neni 32 i Rregullores së DM), vlerësimi i studentëve bazohet në vlerësimin e vazhduar gjatë vitit, që zë 30% të vlerësimit total dhe provimi përfundimtar që zë 70% të vlerësimit total. Format e kontrollit të dijeve, janë të përcaktuara në (nenin 75 të Rregullores së FE), në nenin 33 të Rregullores së DM. Format kryesore janë, testimi i ndërmjetëm/ detyrat e kontrollit, detyrat e kursit, punët në grup, projektet, prezantimet, praktika dhe tezat e diplomës. Sistemi i vlerësimit është i përcaktuar në (nenin 104 të Rregullores së UK), në (nenin 73 të Rregullores së FE), në (nenin 31 të Rregullores së DM), si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Studentët nga zero deri në 39 pikë vlerësohet me notën 4, dhe nga 91 - 100 pikë vlerësohen me notën 10. Në (nenin 96 të Rregullores së UK), në Rregulloren e FE, janë përcaktuar kushtet për hyrje në provim të studentëve, sezonet e provimeve, organizimi i provimeve dhe komisionet e provimeve. Bazuar në (pikën 1, neni 82 të Rregullores së</p>

	<p>FE), pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim, brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit. Në (nenin 103 të Rregullores së UK) si dhe në (nenin 83 të Rregullores së FE), është përcaktuar ankimi. Ankesat bëhen me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimet me shkrim, nga data e dhënies së provimit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Ankesa shqyrtohet nga Dekani, i cili thëret për sqarime përgjegjës të departamentit përkatës, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa është e drejtë apo jo dhe merr vendim të formës të prerë. Kur ankesa është e drejtë, Dekani shpall të pavlefshëm rezultatin e verësimit dhe në bashkëpunim me përgjegjës të departamentit, vendos ngritjen e një komisioni me anëtarë të tjerë që student ta rijapë provimin. Bazuar në (nenin 104, të Rregullores së FE), të gjitha të dhënat e grumbulluara, ruhen në një dosje të veçantë të programit të studimit në arkivën e fakultetit. Në (nenin 14 të Rregullores të Departamentit të Menaxhimit), në përputhje me dispozitat e nenit 101 të ligjit nr. 80/2015, sekretaria e departamentit administron Regjistrin Themeltar të Studentëve si dhe të gjithë dokumentacionin e vlerësimit të studentëve (procesverbal provimi etj), dokumentacionin elektronik nga ESSE3. Sekretaria mësimore, ka për detyrë të hedhë të administrojë dhe të ruajë të dhënat e studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrat bazë në formë të shkruar dhe atë elektronike, regjistrat e notave, të diplomimit dhe në çdo regjistër tjetër të parashikuar nga dispozitat ligjore në fuqi, referuar nenit 3 të Rregullores të sekretarisë mësimore. Të gjitha rregulloret janë të publike, në faqen zyrtare të Universitet “Fan S. Noli”.</p> <p><i>Aneksi I.27: Rregullore e FE</i></p> <p><i>Aneksi I.41: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i></p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullorja e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneksi 1. 2: Rregullorja e Universtit “Fan S. Noli”</i></p> <p><i>Aneksi 1.10: Rregullorja e sekretarisë mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të</p>	<p>Referuar Rregullores të programit të studimit dhe programeve individuale të lëndëve, për programin “Asistent Menaxher”, vlerësimi i vazhdueshmën gjatë vitit, kryet në forma të ndryshme. Mënyrat e verësimit janë kolegiumi, detyra kursi/projekte, kuize, diskutime në</p>

<p>demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>seminare, praktika, duke i dhënë mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Provimi përfundimtar në të gjithë lëndët e këtij program studimi zhvillohet me shkrim dhe përbën 70% të verësimit total.</p> <p><i>Aneks I.25: Programet lëndore</i></p> <p><i>Aneks: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 15)</i></p> <p><i>Aneks I.44: Rregullorja e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni shoqërues u konstatua se studentët janë të informuar me të drejtat dhe detyrimet e tyre, për këtë program studimi. Ata disponojnë rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve. Janë të mirë informuar për mënyrat e vlerësimit, detyrimet gjatë vitit dhe provimin përfundimtar nga pedagogët e lëndëve. Krahas infomimit nga çdo pedagog për lëndën që mbulon, syllabuset e programit të studimit janë publike online për studentët, me anë të aksesit nëpërmjet ESSE3.</p> <p><i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Provimet me shkrim bëhen në fletore të sekretuara. Studentët informohen mbi rezultatet e provimit në librezën e tyre elektronike, sipas përcaktimeve të (pikes 4, neni 82, të Rregullores të FE).</p> <p>Në kuadër të pandemisë Covid -19, mësimi dhe testimi i njohurive edhe për këtë program studim studimi është bërë online, duke përdorur platformat Moodle, Edummet, Google meet, Google clasroom, office 365. Nga takimi i bërë me studentët dhe pedagogët në institucion, konstatojmë se edhe në kushtet e provimeve online, ishte ruajtur anonimati në vlerësimin e studentëve.</p> <p><i>Aneksi: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 17)</i></p> <p><i>Aneksi I.27: Rregullore e FE</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në syllbasin e programit të studimit “Asistent Manaxher”, provimi përfundimtar i lëndëve zë 70% të vlerësimit dhe bëhet nga komisioni i ngritur nga departamenti. Komisioni i provimit përbëhet jo më pak se dy veta, sipas përcaktimeve të (nenit 79, pika 1, e Rregullores të FE), (nenit 100, pika 7 e Rregullores së UNIKO). Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit, në kuadër të të gjithë lëndëve, pjesë e këtij program studimi, ndihmon studentët në procesin e të nxënës, evidenton mangësitë dhe</p>





	<p>krijon mundësi për korrektimin e tyre gjatë semestrit. Departamenti i Manaxhimit zhvillon anketim periodik të studentëve për të kuptuar sa i asimilueshmëm dhe i vlefshëm është materiali i përdorur. Të dhënat, janë pjesë e raportit vjetor të departamentit.</p> <p><i>Aneks 1.2: Rregullore e organizimit dhe veprimtarive kërkimore dhe shkencore e UNIKO</i></p> <p><i>Aneks 1.27: Rregullore e FE</i></p> <p><i>Aneksi 1.44: Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks III. 02: Raporte vjetore të veprimtarisë së departamentit</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Në përputhje me dispozitat e (nenit 82, pika 1, të Rregullores së FE), rezultat e provimit bëhen me dije brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të provimit me shkrim. Ankimi është i mundur jo më vonë se 8 ditë për provimet me shkrim dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Kur ankesa është e drejtë, shpallet pavlefshmëria e rezultatit, dhe ngrihet një komision me anëtarë të tjerë të departamentit, për rihënien e provimit, jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës, sipas nenit 83, pika 3, e Rregullores të FE. Nga vizita në institucion, takimi me studentët e programit të studimit, konstatoam se, nuk ka pasur probleme në gatimin e të drejtave të tyre, në lidhje me vlerësimin.</p> <p><i>Aneks 1.27: Rregullore e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Aneks I. 25: Programet lëndore</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<p><b>Standardi III.5</b></p> <p><b>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim të njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që</p>	<p>Plani mësimor i programit “Asistent Menaxher”, është në funksion të përmbushjes së objektivave formues të këtij programi, përgatitja e specialistëve të aftë, në përputhje dhe kërkesat e tregut rajonal të punës, që do të kryejnë</p>

<p>janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>funksionet e asistentit menaxher. Programi zhvillon aftësi profesionale të tilla si aftësi komunikuese, aftësi në vlerësimin e performancës së punonjësve, aftësi në kryerjen organizimin e kohës, zgjidhjen e konflikteve etj, në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit.</p> <p><i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i></p> <p><i>Aneks I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Programi i studimit, në përputhje me zhvillimin që ka marrë teknologjia e informacionit dhe aplikacioni i saj në biznes, ka pjesë të tij si lëndë karakterizuese “E –business dhe komunikimi elektronik” dhe “Organizimi i informacionit dhe të dhënave” dhe “Hyrja në informatikë”, si lëndë bazë, me qëllim zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Pjesë e lëndëve ndërdisipinore zhvillohet në lëndët “Sociologji/Psikologji” dhe “Marrëdhënie me konsumatorin/ Planifikimi i aktiviteteve”, në funksion të zhvillimit të aftësive që duhet të ketë një asistent menaxher që të përmbushë me sukses detyrat që i ngarkohen nga menaxheri. Përfshirja e dy gjuhëve të huaja “Anglisht” dhe “Frëngjisht”, është gjithashtu e vlefshme jo vetëm për shfrytëzimin e të gjithë literaturës ndihmëse të programit të studimit, por ndihmon edhe realizimin e funksionit të tyre si asistent menaxher, në marrëdhënie me klientët e huaj.</p> <p><i>Në funksion të detyrave të mbajtjes të korenspondencës zyrtare dhe hartimi i raporteve, që një asistent menaxher do të kryejë, GVJ rekomandon të konsiderohet përfshirja në programin e studimit e lëndës “Kulturë gjuhe shqipe”.</i></p> <p><i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i></p> <p><i>Aneks: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 9)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar</p>	<p>Në programin e studimit “Asistent Menaxher”, nuk ka orë të planifikuara laborator. Nga vizita në institucion dhe takimi me pedagogët e programit dhe studentët, u informuam se lëndë të ndryshme si “Hyrje në Informatikë”, “Statistikë”, “Excel”, “E –business dhe komunikimi elektronik” dhe “Organizimi i informacionit dhe të dhënave”, përdorin laboratorin për shpjegimin e leksionit dhe zhvillimin e ushtrimeve praktike dhe detyrave. Me qëllim zhvillimin e praktikave mësimore, kërkimin shkencor të përbashkët, leksione të hapura etj, Univesiteti “Fan S. Noli” ka nënshkruar një sërë</p>

<p>formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>marrëveshje bashkëpunimi. Depamenti i Manaxhimit si njësi bazë, që ofron këtë program studimi, ka nënshkruar 7 marrëveshje bashkëpunimi. Fakulteti Ekonomik si njësi kryesore, ka nënshkruar 11 marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Krahas praktikës mësimore që zhvillohet në vitin e dytë, semestrin e dytë, dhe që vlerësohet me 5 ECTS, me qëllim rritjen e orëve praktike gjatë vitit akademik janë zhvilluar leksione të hapura nga Fakulteti Ekonomik, ku mund të përmendim “Etika profesionale”, zhvilluar në datë 21.06.2019, “Vendim marrja në bazën e të dhënave”, zhvilluar në datë 14.05.2021. Për këtë program studimi, nuk ka pjesëmarrës të studentëve në programe shkëmbimi, si Erasmus. Nga vizita në institucion, takimi me studentët e këtij program studimi, është kërkuar nga studentët rritja e orëve praktike gjatë vitit.</p> <p><i>Aneksi I.35: Marrëveshje institucionale</i>  <i>Aneksi I.36: Marrëveshje bashkëpunimi</i>  <i>Aneksi: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 5)</i>  <i>Aneksi I.28: Leksione të hapura</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i studentëve, në të gjitha lëndët e këtij program studimi, është i vazhduar gjatë vitit në masën 30% dhe provimi përfundimtar me shkrim 70%. Nga vizita në institucion, konstatoam se në çdo semestër zhvillohen anketime me studentët, si në kuadër të vlerësimit të brendshëm nga NJSBC –ja, ashtu edhe nga pedagogë të lëndëve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të lëndës në funksion të aftësive dhe kompetencave të kërkuara nga tregu i punës. Konkluzionet e nxjerra nga analiza e të dhënave të grumbulluara nga regjistrat dhe pyetësorët, është pjesë e raportit të NJSBC -së dhe raportit vjetor të punës së Departamentit të Menaxhimit.</p> <p><i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i>  <i>Aneksi III.01: Model pyetësori studentor i organizuar nga FE</i>  <i>Aneksi III.02: Raporti vjetor i veprimtarisë së departamentit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit, studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit, pra që kanë 114 kredite kanë të drejtën e përgatitjes të një teze diplome. Departamenti ka përgatitur udhëzues diplome për studentët. Të gjithë temat e diplomës udhëhiqen nga një pedagog dhe kanë dhe një pedagog oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij. Komisioni i vlerësimit të temave të diplomës përbëhet jo më pas ke 3 (tre)</p>

dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.	<p>pedagogë, prej të cilëve njëri oponent. Universiteti “Fan S. Noli”, ka Rregullore për mbrojtjen, përpunimin ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Bazuar në Rregulloren e sekretarisë mësimore, të dhënat e studentëve, hidhen, administrohen dhe ruhen fizikisht dhe dhe në formë elektronike në sistemin ESSE3, në regjistrat bazë, regjistrat e notave, të diplomimit dhe çdo regjistër tjetër të parashikuar nga dispozitat ligjore në fuqi.</p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i>  <i>Aneksi II.04: Udhëzues punimi diplome</i>  <i>Aneksi I.09: Rregullorja e ruajtjes së të dhënave</i>  <i>Aneksi I.10: Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Për përgatitjen e temës së diplomës dhe praktikës profesionale, Departamenti i Menaxhimit ka hartuar udhëzues punimi diplome dhe udhëzues praktike profesionale. Në Rregulloren e programit të studimit është përcaktuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të gjithë temat e diplomës bëhen nën drejtimin e pedagogut udhëheqës;</li> <li>- Monitorimi dhe vlerësimi i performacës së studentit në praktikën profesionale bëhet nga drejtuesi i praktikës;</li> </ul> <p>Në funksion të realizimit të temës së diplomës, detyrave të kursit/ projekteve, studentët e këtij kursi është biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë, e cila ka 5300 tituj librash, 46 vende leximi dhe 3 komputera për përdorim nga studentët. Rezultatet e praktikës profesionale, janë përmbledhur në relacioni e praktikës.</p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i>  <i>Aneksi I. 37: Relacione praktike</i>  <i>Aneksi I.39: Udhëzues praktike</i>  <i>Aneksi II. 04: Udhëzues diplome</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
--------------------------	-----	------------	------------	------------



standardeve të fushës III	përmbyset	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB si edhe gjatë vizitës në institucion, rezulton se Universiteti “Fan S. Noli”, ka një tërësi rregulloresh dhe dokumentash të mbështetur në bazën ligjore në lidhje me procedurat e rekrutimit të stafit akademik. GVJ gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin e burimeve njerëzore, konsultoi një praktikë konkrete, të zbatimit të këtyre procedurave. Staf i burimeve njerëzore shprehet se Universiteti “Fan S. Noli” zbaton rregulloret e rekrutimit si dhe përzgjidhen më të mirët (duke parë institucionet ku kandidatët kanë kryer studimet universitare dhe ato pas universitare, notat në lëndë përkatëse etj) jo vetëm në fushën akademike por edhe në ekspertizën profesionale të tyre. GVJ, konstaton se Universiteti “Fan S. Noli” ka një procedurë në të cilën identifikohen, kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit, sipas ligjeve në fuqi. Shpallja e vendeve vakante dhe kriterëve të përgjithshme dhe specifike për kandidatët bëhet në faqen zyrtare të Universitetit “Fan S. Noli”.</p> <p><i>Aneks IV.02 Format Shpallje vendi vakant</i>  <i>Aneks IV.03 Format Vendimi komisioni ad-hoc</i>  <i>Aneks IV.04 Model kontrate individuale e punes</i>  <i>Aneks IV.05 Format urdher emerimi</i>  <i>Aneks IV.06. Kriteret e rekrutimit</i>  <i>Aneksi 1.1.1: Draft Statuti i ndryshuar i Universitetit “Fan S. Noli”</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të</p>	<p>GVJ konstatoi se Universiteti “Fan S. Noli”, në lidhje me kete program, disponon të dhënat për çdo semestër, për</p>

<p>angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>cdo vit akademik, të stafit akademik që përfshihet në program. Në këto të dhëna përcaktohen edhe lëndët që mbulon secili anëtar i stafit akademik si dhe statusin e tij. Personi përgjegjës për organizimin e programit të studimit (kordinatori) ka gradën shkencore “Profesor i Asociuar” Duke ju referuar edhe dokumentacionit GVJ, nga konsultimi i dosjeve të stafit të programit, rezulton se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore (1 PAK dhe 1 PAE), gjendet dokumentacioni si, kontratë e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, formular i vetdeklarimit ose vërtetim i gjendjes gjyqësore, raport mjeko-ligjor, CV, çertifikata kualifikimesh apo pjesmarrjesh në konferenca etj.</p> <p><i>Aneks II.09 Koordinatori i programit te studimit</i> <i>Aneksi IV.09 Ngarkesa mesimore e stafit te programit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga i gjithë dokumentacioni është evidente që Institucioni dëshmon një angazhim të plotë të burimeve njerëzore, për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Referuar dokumentave që shoqërojnë stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për dy vitet akademike është:</p> <p>Referuar dokumentit (<i>tabela permbledhese_rvb-uk_prog_studimi_as. menaxher.pdf</i>), të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë dy viteve akademike janë si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik <b>2020-2021</b> janë të angazhuar <b>24</b> pedagogë ndër të cilët <b>20 PAE, nga ku 18 me grada/tituj dhe 4 PAK.</b></p> <p>Mbulimi i programit në përqindje si numër fizik është <b>84% PAE dhe 16% PAK.</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2021-2022</b> janë të angazhuar <b>23</b> pedagogë, ndër të cilët <b>19 PAE, nga ku 18 me grada/tituj dhe 4 PAK.</b></p> <p>Mbulimi i programit në përqindje si numër fizik është <b>83% nga PAE dhe 17% PAK.</b></p> <p>Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion, GVJ konstaton që pjesa më e madhe e orëve mësimore të këtij programi studimi për vitin akademik 2020-2021 mbulohet nga staf akademik me kohë të plotë.</p> <p>Konkretisht 90% të orëve mësimore të këtij programi,</p>

	<p>mbulohen nga staf akademik efektiv (PAE) dhe 10% të orëve mësimore mbulohen nga staf akademik PAK.</p> <p><i>Aneksi IV.09 Ngarkesa mesimore e stafit te programit</i> <i>tabela permbledhese_rvb-uk_prog_studimi_as_menaxher.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga takimet me stafin akademik, rezulton se Fakulteti Ekonomik, organizon leksione të hapura për metodat inovative të mësimdhënies, dhe lektorët e këtij programi studimi kanë patur trajnime të mirefillta. Në faqen e internetit të institucionit pasqyrohen aktivitetet që shërbejnë për nxitjen dhe inkurajimin e punës në të ardhmen. Gjithashtu Univesiteti “Fan S. Noli” ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi. Departamenti i Manaxhimit si njësi bazë, që ofron këtë program studimi, ka nënshkruar 7 marrëveshje bashkëpunimi. Fakulteti Ekonomik si njësi kryesore, ka nënshkruar 11 marrëveshje bashkëpunimi. Gjithashtu, bazuar në dokumentacion por edhe gjatë takimit me stafin akademik dhe përgjegjës të departamentit në institucion, GVJ, konstaton platformën për mësimin online për periudhën e Covid 2019 shoqëruar edhe me udhëzimin mbi mësimdhënien në distancë Gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik u shpreh se kanë patur mbështetje të vazhdueshme nga institucioni për kërkimin shkencor. Sipas tyre, respektohet vjetërsia në punë për trajnimet apo edhe mbështetja financiare për pjesëmarrje në aktivitetet, apo projekte. Sipas stafit të Fakultetit Ekonomik, çdo anëtar i stafit akademik, ka marrë pjesë të paktën një herë në mobilitetet Erasmus, për shkëmbim stafi për trajnim apo mësimdhënie. Stafi akademik i programit me karakter profesional shprehet se ka mirëkuptim dhe frymë bashkëpunimi mes tyre dhe institucionit.</p> <p><i>Aneksi V.03 Kalendari i veprimtarive</i> <i>Aneksi IV.07 Aktiviteti kerkimor shkencor</i> <i>Aneksi V.08 Kualifikimi stafit akademik</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

**Standardi IV.2**  
**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për**

**formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Univesiteti “Fan S. Noli” siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë. Rezulton se institucioni disponon, laboratorë, klasa, zyra, biblioteka, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e këtij program studimi. Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave për infrastukturën, GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimin të programit të studimit. Leksionet dhe seminarët, zhvillohen në klasat që i përkasin Fakultetit të Ekonomisë, dhe po ashtu edhe laboratorët e përdoruar. Institucioni, e plotëson kërkesën ligjore për ofrimin e kapaciteteve prej minimumi 5 m<sup>2</sup> për student.</p> <p><i>Aneksi III.04 Te dhena per infrastrukturen</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 4 laboratorë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se laboratorët që disponojne janë me pajisjet e duhura harduerike dhe softuerike që studentëve ju nevojiten.</p> <p><i>GVJ, sugjeron shtimin e oreve të laboratorëve dhe përdorimin e tyre për disa lëndë.</i></p> <p><i>Aneksi III.04 Te dhena per infrastrukturen</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas</p>	<p>Sallat e leksioneve dhe seminarëve për këtë program studimi janë të pajisura me kompjuter dhe vidioprojektor, si edhe me tabela për të mundësuar një proces mësimdhënie efektiv.</p> <p>Laboratorët që Fakultetit i Ekonomisë disponon dhe që përdoren edhe për këtë program studimi, janë të pajisura me pajisjet e duhura harduerike dhe softuerike që studentëve ju nevojiten</p>



natyrës së programit/eve të studimit që ofron.									
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Praktika profesionale zhvillohet pranë bizneseve me të cilat Fakultetit i Ekonomisë ka marrëveshje bashkëpunimi. Praktika zhvillohet, në vitin e dyte, semestri i dytë (5 kredite). Studentët që kanë bizneset e tyre familjare e zhvillojnë praktikën pranë këtyre bizneseve, ndërsa të tjerët e zhvillojnë në kompanite që institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Në fund të praktikës, studenti vlerësohet për periudhën e praktikës sipas aktiviteteve përkatëse nga përfaqësuesi i kompanisë ku është zhvilluar praktika. Për vitin akademik 2019-2020, përgjegjësi i departamentit, u shpreh se kishte vështirësi për realizimin e praktikës profesionale, kjo për shkak të Codiv 2019. Kompanitë e kishin të vështirë të pranonin studentë për praktikë dhe pjesa më e madhe e tyre e kishte realizuar praktikën në bizneset familjare ose në biznese të të njohurve dhe të afërmeve të tyre.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor, institucioni vë në dispozicion të studentëve pa pagesë bibliotekën mësimore, në mënyrë që të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe mundësi të barabartë për të gjithë studentët. Biblioteka mund të përdoret nga studentët pa kufizime gjatë orarit zyrtar që biblioteka qëndron e hapur. Biblioteka disponon vende të mjaftueshme për studentët dhe u ofron atyre mundësinë për të studiuar, për të përdorur literaturën mësimore bazë apo ndihmëse duke përdorur kompjuterat që biblioteka disponon ose kompjuterat personalë, të vënë në dispozicion të studentëve nga institucioni në fillim të periudhës të studimit.

<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmojnë studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore. Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë ka në dispozicion të studentëve mbi 4833 tituj, në gjuhën shqipe, angleze dhe në gjuhën frënge. Studentët e këtij program studimi, krahas gjuhës angleze zhvillojnë dhe gjuhën frënge, duke patur mundësi të shfrytëzojnë literaturën e ofruar.</p> <p><i>Aneksi III.06 Librat dhe biblioteka</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Përveç bibliotekës fizike, studentët dhe stafi akademik kanë në dispozicion bibliotekën dixhitale U –library dhe E –Library. Përdorimi i literaturës online siguron të gjithë materialet e nevojshme për të përvetësuar leksionet, aksesin në artikuj shkencor dhe raste studimore, është nevojshëm për të përgatitur detyrat e kursit, esetë, dhe prezantuar raste studimore, gjatë orëve të seminarit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Bazuar në RVB si edhe në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë në vend dhe jashtë si edhe anëtarësime në rrjete në të cilat grupet e interesit janë stafi akademik dhe studentët. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur por edhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Fakultetit i Ekonomisë ka lidhur 11 marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete dhe institucione të tjera.</p> <p><i>Aneksi I.36 Marrëveshje bashkëpunimi</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe në RVB evidentohet se institucioni bën një parashikim të kostove financiare për një student për një cikël të plotë studimi.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka dhe një rregullore financiare dhe dokumenta për fondet dhe të ardhurat. GVJ konstaton se të</p>

financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	dhënat financiare të hartuara janë në nivel institucioni dhe fakulteti por jo për program studim. <i>Aneksi IV.10 Kosto per student</i> <i>Aneksi IV.12 Rregullore financiare</i> <i>Aneksi IV.11 Fondet dhe te ardhurat</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Për programin e studimit me karakter profesional "Asistent Menaxher" bazuar në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tij mbështetëse, Departamenti i Menaxhimit harton dhe miraton kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi. Kriteri kryesor për këtë program studimi me karakter profesional është që kandidatët të kene përfunduar me sukses Maturën Shtetërore. Kandidatët nuk kanë detyrim të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar me VKM, nr. 436  Renditja e kandidatëve fitues, bazohet në Nenin 76, i Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë, Udhëzimin nr.17, datë 30.07.2019, (i ndryshuar) dhe realizohet nga Komisioni vlerësues i ngritur pranë Departamentit të Menaxhimit. Për të ndjekur rrugëtimin e studentëve dhe për t'u siguruar atyre mbështetje në strukturën e tij institucioni ka edhe Zyrën e

	<p>këshillimit të karrierrës. Gjatë takimit që GVJ pati me përfaqësues të kësaj zyre, ata u shprehën se këshillimi i studentëve fillon që me kandidatët që duan të zgjedhin këte program studimi. Gjatë takimeve të tilla përfaqësuesit e kësaj zyre informojnë në detaje për programet e studimit si edhe i orienton dhe këshillon kandidatët për programet e studimit në lidhje me detajet e programit të studimit si edhe me mundësitë e punësimit. Informimi i kandidatëve për programet e studimit bëhet gjithashtu edhe në takimet e organizuara në kuadër të ditëve të informimit për gjimnazistët për programet e studimit.</p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për programet e studimit jepen në rregulloren e këtij programi studimi ku referuar Udhëzimeve të MASR mbi procedurat e aplikimit dhe rregjistrimit në vitin akademik 2021-2022 ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në këtë program studimi çdo person që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ose që zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të. Kandidatët nuk kanë detyrim të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar me VKM, nr. 436, datë 03.06.2020 Programin e studimit me karakter profesional mund ta ndjekin edhe studentë të huaj që plotësojnë kushtet sipas Udhëzimeve të MASR mbi procedurat e aplikimit dhe rregjistrimit në vitin akademik 2021-2022. Renditja e kandidatëve fitues, bazohet në Nenin 76, i Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë, Udhëzimin nr.17, datë 30.07.2019, (i ndryshuar) dhe realizohet nga Komisioni vlerësues i ngritur pranë Departamentit të Menaxhimit bazuar në kapacitetet pritëse të Institucionit dhe stafin akademik</p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, nga RVB por edhe nga takimi që GVJ pati me drejtuesit, stafin akademik si edhe studentët e programit me karakter profesional konstatoi se informimi në lidhje me lëndët që zhvillohen, ndarjen e krediteve sipas veprimtarive formuese apo edhe detyrimet e lëndës bëhen të ditura nga pedagogu i lëndës në fillim të cdo semestri. Gjithashtu bëhet e ditur edhe mënyra e vlerësimit për çdo lëndë sipas syllabusit të miratuar në departament. Sipas</p>

<p>dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>stafit akademik dhe drejtuesve, numri i studentëve në programin me karakter profesional e bën më të lehtë komunikimin me studentët apo edhe orientimin e tyre për praktikën profesionale.</p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i>  <i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i>  <i>Aneksi I.27: Rregullore e FE</i>  <i>Aneksi I.41: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i>  <i>Aneksi I. 2: Rregullorja e Universtitit "Fan S. Noli"</i>  <i>Aneksi I.10: Rregullorja e sekretarisë mësimore</i>  <i>Aneksi I. 37: Relacione praktike</i>  <i>Aneksi I.39: Udhëzues praktike</i>  <i>Aneksi II. 04: Udhëzues diplome</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacion, konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik dhe ndihmes, sikurse edhe në faqen eeb të institucionit. Studentët gjithashtu informohen në fillim të vitit akademik, edhe për ambjentet që do të përdoren për zhvillim e procesit mësimor (sallat e leksionit, seminarit, laboratorret etj).</p> <p>Studentët nëpërmjet postës elektronike dhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit "Fan S. Noli". Platforma ESSE4 mundëson që pavarësisht distancës, studentët të kenë informacion dhe akses në lidhje me materialet e lëndëve mësimore, detyrimet e lëndës, komunimi për notën etj.</p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i>  <i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i>  <i>Aneksi I.27: Rregullore e FE</i>  <i>Aneksi I.41: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i>  <i>Aneksi I. 2: Rregullorja e Universtitit "Fan S. Noli"</i>  <i>Aneksi I.10: Rregullorja e sekretarisë mësimore</i>  <i>Aneksi I. 37: Relacione praktike</i>  <i>Aneksi I.39: Udhëzues praktike</i>  <i>Aneksi II. 04: Udhëzues diplome</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>



				X
--	--	--	--	---

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet në strukturat përkatëse. Këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore. Platforma ESSE4 mundëson që pavarësisht distancës, studentët të kenë informacion dhe akses në lidhje me materialet e lëndëve mësimore, detyrimet e lëndës, komunimi për notën etj. Kjo platformë shërben si mënyrë komunikimi për çdo problematikë midis studentëve dhe institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ pati në institucion konstatoi se informacioni për stafin akademik dhe ndihmës akademik disponohej nga departamenti por edhe nga zyra e burimeve njerëzore e cila dispononte gjithashtu informacion edhe për personelin administrative. Departamenti mban informacion në lidhje me aktivitetin shkencor të secilit prej stafit akademik si edhe performancën e tyre. Këto të dhëna rezultuan të jenë kryesisht manual dhe nuk ka një system informacioni për të mbajtur të dhënat në lidhje me stafin akademik dhe personelin administrative. GVJ sygjeron një system për menaxhimin e informacionit për stafin akademik jo vetëm actual por edhe atë në vite.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit që siguron akses për studentët e programit është platforma ESSE4 nga RASH. Platforma mundëson që pavarësisht distancës, studentët të kenë informacion dhe akses në lidhje me detyrimet e lëndës, komunimi për notën etj. Kjo platformë shërben si mënyrë komunikimi për çdo problematikë midis studentëve dhe institucionit. Referuar takimit me studentët, rezultoi se studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre personale në platformë, kanë akses në informacionin në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive. GVJ referuar rregullores, konstaton se të dhënat për studentët ruhen në formë manuale dhe në regjistra elektronik. Gjatë</p>

	<p>vizitës në institucion, GVJ-së, ju vu në dispozicion nga sekretaria mësimore rregjistri manual i studentëve të programit. Notat e studentëve në përfundim të lëndës pra nota e provimit hidhet në sistem nga pedagogu i lëndës. Notat gjithashtu hidhen në regjistrin elektronik dhe nga sekretaria. GVJ në takimin me sekretarinë, ju komunikua se procesverbalet e provimeve mbahen në sekretarinë mësimore dhe më pas arshivohen në zyrën e arkivës së përhershme ku ruhen duke u bazuar në legjislaturën përkatëse.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ pati në institucion me stafin akademik si edhe me studentët e programit të, konstatoi se komunikimi apo shkëmbimi i informacionit ndërmjet stafit dhe studentëve kryhet nëpërmjet email-it si edhe nëpërmjet platformës Google Meet, Moodle. Platformat përdoren për mësimdhënien, për vendosjen e materialeve nga ana e stafit akademik, mbajtja e mungesave, për komunikim midis stafit akademik dhe studentëve etj. Gjithashtu për pjesën e mësimdhënies online përdoret edhe “go to meeting” dhe “classroom” të cilat u përdorën për procesin e mësimdhënies online gjatë periudhës Covid-19</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Platforma Google Meet, Moodle. i mundëson titullarëve si edhe organeve drejtuese të institucionit të monitorojnë në kohë reale zhvillimin e aktivitetit mësimor (sidomos në rastin kur mësimi u zhvillua online).</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen ëeb të institucionit, jepet informacion në gjuhën shqipe dhe angleze, në lidhje me programet e studimit, personelin akademik apo edhe aktivitetet e ndryshme. Madje në faqen ëeb bëhen publike edhe lajmërimet për vendet vakante për stafin akademik apo edhe atë administrativ. Gjithashtu një pjesë e këtyre informacioneve bëhen publike në mediat sociale ku Universiteti “Fan S. Noli” është aktiv.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>
---------------------------------	------------	-------------------	-------------------	-------------------

<b>standardeve të fushës IV</b>	<b>përmbushet</b>	<b>pjesërisht</b>	<b>kryesisht</b>	<b>plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga dokumentacioni i administruar dhe vizita në institucion konstatojm se, kriteret për vlerësimin e studentëve janë të sanksionuar në rregulloren e programit të studimit, ato paraqiten edhe në programet e çdo lënde. Studentët kanë dijeni për to dhe konfirmojnë se vlerësimi i tyre është bërë siç është parashikuar në programin e lëndës. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve në programin “Asistent Menaxher”, janë të publikuara në faqen zyrtare të univesristetit, dhe mund të aksesohen nga të gjithë të interesuarit. Pika 5, neni 51, i Statutit të Universitetit, përcakton se pranimet në Universitetin “Fan S. Noli” në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standartet shtetërore, kapacitet akademike dhe infrastrukurore. Kriteret e pranimit të studentëve në programin me karakter profesional “Asistent Menaxher”, janë përcaktuar në pikën 7, të Rregullores së programit të studimit.</p> <p>Bazuar në (nenin 66 të Statutit), (nenin 60 të Rregullores të FE), (nenin 37 të Rregullores së Departamentit të Menaxhimit) dhe pikën 15 të Rregullores së programit të studimit, Fakulteti i Ekonomisë pranon transferim studentësh në programin me karakter profesional. Njohja kryet nga fakulteti pranë të cilit është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve, konform kërkesave dhe standarteve të vendosura në Rregulloren e Universitetit “Fan S. Noli” për Veprimtarinë e Komisionit të Ekuivalentimit të Moduleve dhe Programeve Mësimore, në përputhje me nenin 89, pikat 4,5,6, të ligjit nr. 80/2015. Studentët që kanë grumbulluar 114 kredite kanë të drejtë e përgatitjes të një teze diploma në fushat e programit “Asistent Menaxher”. Bazuar në (nenin 70 të Statutit), çdo diplomë dhe</p>



	<p>certifikatë, përpara se të lëshohet nga Universiteti “Fan S. Noli”, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Statuti i univesitetit dhe rregulloret janë publike në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p><i>Aneksi I.1.1: Statuti i Universitetit</i></p> <p><i>Aneksi I.27: Rregullore e FE</i></p> <p><i>Aneksi I.41: Rregullore e DM</i></p> <p><i>Aneksi I. 44: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe vizita në institucion, konstatohet se Universiteti “Fan S. Noli” ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi, tek njësia kryesore dhe tek njësia bazë, apo edhe e programit të studimit që mbulojnë një cikël të plotë 2 vjeçar nga hyrja deri në diplomim të studentëve në programin “Asistent Menaxher”. Këto akte nënligjore sanksionojnë të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët. Formulari i Vlerësimit të studentit, demonstron reflektimin e kriterëve të vlerësimit të parashikuara në rregullore. Bazuar në <i>(nenin 51, pika 5, e Statutit)</i>, pranimet e studentëve në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standartet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore. Pas hyrjes në programin e studimit, studentët kanë akses në programin ESSE3 dhe në U-library. Për orjentimin e studentëve drejt tregut të punës organizohen module orjentuese për procesin e kërkimit dhe hyrjen në tregut e punës.</p> <p><i>Aneksi I.1.1: Statuti i Unviversitetit</i></p> <p><i>Aneksi I.26: Module orjentuese për studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se, Senati akademik i Universitetit “Fan S. Noli”, mbështetur në rregulloren e institucionit, miraton çdo vit kriteret të veçanta. Kandidatët nuk kanë detyrim që të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM nr. 436, datë 03.06.2020, e ndryshuar me VKM nr. 46 datë 21.01.2021. Të drejtën për të aplikuar në këtë programin e studimit me karakter profesional “Asistent Menaxher”, e ka çdo person që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ose që zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar dhe ekuivalentuar me të, referuar Rregullores të</p>

	<p>programit të studimit.</p> <p>Plani i veprimit për “Ditët e informimit të maturantëve”, hartohet nga Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor. Plani i veprimit përfshin, informimin e DAR në rajonin e Korçës, përcaktimi i grupeve të promovimit, hartimi i grafikut përmbledhës të vizitave. Nga vizita në institucion, konstatoam se në periudhën e pandemisë, promovimi i programit të studimit është bërë online, duke përdorur platformën Zoom. Informacioni mbi programin e studimit është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Universitetit.</p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullorja e programit të studimit</i>  <i>Aneksi II. 13: Kalendari i promovimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, konstatoam se institucioni, mban të dhëna të plota të përparimit akademik të studentëve, proceverbalet e notave etj. Kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe të diplomimit, janë të përcaktuara në <i>(nenin 38, të Rregullores të FE)</i>. Gjithashtu institucioni informon për detyrimet e studentëve për të kaluar nga një vit në tjetrin, ku minimum është 20 ECTS të siguruara nga viti paraardhës. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve, janë në përputhje me ligjin nr. 80/2015. Procedurat për njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e modeluve, janë përcaktuar në <i>(nenin 86, 87, 88 të Rregullores të FE)</i>, si dhe në Rregulloren e programit të studimit, seksioni 15. Sekretaria informon studentët në fillim si dhe për çdo kërkesë specifike rreth kriterëve, kushteve, dokumentacionit për transferimet, të parashikuara këto në rregullore. Studentët rezultuan të informuar për kriteret dhe procedurat e vlerësimit si dhe detyrimet lëndore, nga pedagogët në seancën e parë të çdo lënde si dhe në Portalin e Studentit.</p> <p><i>Aneks I.27: Rregullore e FE</i>  <i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatoam se, format e mësidhënies dhe të vlerësimit të dijeve janë të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit, seksioni 12 si dhe në kreun IX dhe X të Rregullores së FE. Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit, zë një peshë prej 30% të vlerësimit total. Nga syllabuset e programit të studimit, konstatojmë së forma e vlerësimi është e ndryshme në varësi të lëndës, duke respektuar lirinë akademike. Diplomimi është përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit, në</p>


	<p>seksionin 14. Me qëllim orjentimin e punës së studentëve për temën e diplomës, nga departamenti është hartuar udhëzues për punimin e diplomës.</p> <p><i>Aneks I.27: Rregullore e FE</i></p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks I.25: Programet lëndore</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se, përpara fillimit të çdo viti akademik, Universiteti “Fan S. Noli”, sipas një plani të mirë përcaktuar, organizon takime për informimin e maturantëve me programet e studimit që ofrohen nga ky universitet. Për qëllim informimi dhe promovimi të programeve të studimit përdoren fletëpalosje dhe mbështetje me materiale video. Këto informacione promovuese publikohen edhe në faqen zyrtare të institucionit, për të rritur vizibilitetin dhe informimin e maturantëve të interesuar. Qendra e Karrierës dhe Alumnit, ofron shërbim mbështetës për maturantët para dhe gjatë pranimit në universitet.</p> <p><i>Aneks II.13: Kalendari i promovimit</i></p> <p><i>Aneks I.46: Analiza e veprimtarisë së Qendrës së Karrierës dhe Alumnit</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit konstatohet se, studentët mund të informohen nga Guida e studentëve, e cila krijon mundësi informimi për programin e studimit si dhe aktivitetet të ndryshme që zhvillohen nga universiteti. Studentët marrin informacion për organizimin e studimeve në kreun IX të Rregullores të FE, si dhe një informacion më të detajuar në Rregullen e programit të studimit “Asistent Menaxher”. Në Rregullore është përcaktuar se programi zgjat 2 vite akademike, është me kohë të plotë, në gjuhën shqipe dhe ka në total 120 kredite.</p>

	<p>Në pikën 8 të Rregullores të programit, jepet struktura e planit mësimor, sipas përcaktimeve të VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, e ndryshuar me VKM nr. 875, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185 datë 25.03.2021. Rregulloret, plani mësimor dhe syllabuset janë të aksesueshme për studentët online, në sistemin ESSE3. Në programet e lëndore, jepet informacion i detajuar për secilën lëndë. Nga takimi me studentët, rezulton se ata informohen nga pedagogët, mbi kërkesat që ata kanë për informacion rreth lëndëve specifike, detyrimeve lëndore, etj.</p> <p><i>Aneks I.27: Rregullore e FE</i></p> <p><i>Aneks I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks I.25: Programet lëndore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Studentët e programit të studimit, janë të informuar për zhvillimin e praktikës profesionale, në vitin e dytë, semestri i dytë. Praktika profesionale përmban 125 orë, dhe vlerësohet me 5 ECTS. Për realizimin e praktikave profesionale, Departamenti i Menaxhimit ka nënshkruar marrëveshje specifike për këtë program studimi, ndërkohë që njësia kryesore Fakulteti i Ekonomisë ka marrëveshje bashkëpunimi me firma biznesi dhe institucione shtetërore që mund të shfrytëzohen edhe nga studentët e këtij programi. Në Rregulloren e programit të studimit, në pikën 4, janë të përcaktuara mundësitë e punësimit bazuar në aftësitë e fituara nga programi “Asistent Menaxher”. Qendra e Karrierës dhe Alumnit, zhvillon si pjesë të veprimtarisë së saj panairin e karrierës, asistencë për realizimin e instrumentave të kërkimit të një vendi pune, takime me biznese, organizata, institucione shtetërore për bashkëpunime.</p> <p><i>Bazuar në faktin që për këtë program studimi në dy vite akademike 2019-2020 dhe 2020-2021, kemi në total 38 të diplomuar, por asnjë të punësuar si “Asistent menaxher”, rekomandojmë që Qendra e Karrierës dhe Alumnit të intensifikojë aktivitetet informuese për studentët e këtij programi, për mundësitë e punësimit të tyre, për t’i orientuar ata drejt tregut të punës.</i></p> <p><i>Aneks I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneksi: Tabela përbledhëse (tabela nr. 5, nr. 21)</i></p> <p><i>Aneks V.03: QKA –Kalendari i veprimtarive</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar nga takimi me studentët e programit “Asistent Menaxher”, konstatojmë se studentët janë të informuar për organizimin e procesit mësimor, orarin mësimor, aktivitete të arganduara nga Fakulteti Ekonomik. Koordinator i programit është një anëtar efektiv i departamentit, bazuar në <i>(nenin 9 të Rregullores së Departamentit të Menaxhimit)</i>. Koordinator është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e programit, koordinon organizimin e veprimtarive me karakter kërkimor –shkencor, si dhe informon vazhdimisht titullarin e njësisë mbi ecurinë e zbatimit të programit. Informacioni dërgohet me email zyrtar tek studentët, është online në sistemin ESS3, dhe rrjete sociale të fakultetit.</p> <p><i>Aneksi I.41: Rregullore e brendshme e Departamentit të Menaxhimit</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga dokumentacioni i administruar dhe vizita në institucion, konstatojmë se i gjithë informacioni në lidhje me programin e studimit, aktivitete të ndryshme që zhvillohen nga fakulteti, trajnime dhe mundësi punësimi është online në faqen zyrtare të universitetit, në sistemin e brendshëm ESSE3, dhe mund të aksesohet lehtësisht nga studentët. Studentët mund të aksesojnë online U -library, dhe të përdorin të gjithë literaturën e nevojshme për të përgatitur esse, projektet e kursit, raste studimore dhe punimin e diplomës, në kuadër të programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi I.41: Rregullore e brendshme e departamentit të menaxhimit</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimitë në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon	Nga dokumentacioni i administruar, konstatojmë se në total

<p>dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>të diplomuar në programin e studimit “Asistent Menaxher” janë 38 studentë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2019-2020 janë 15 studentë të diplomuar;</li> <li>- Për vitin akademik 2020 -2021 janë 23 studentë të diplomuar;</li> </ul> <p>Nga vizita në institucion, konstatoam se mbahen statistika vjetore, të cilat janë pjesë e raportit vjetor të punës të Departamentit të Menaxhimit. Bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 80/2015, institucioni disponon në formë të shkruar, regjistrin themeltar të studentëve, rregjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin për lëshimin e diplomave dhe certifikave. Mbajtja e këtij dokumentacioni, parashikohet në nenit 82, pika 1 të Statut të Universitetit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që Departamenti i Menaxhimit, në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumnit, të evidentojë shkaqet e mungesës së punësimit të studentëve pas diplomimit, pasi mungojnë të dhënat e punësimit jo vetëm në përputhje me diplomën “Asistent Menaxher” por edhe për punësimin e studentëve jo në përputhje me diplomën.</i></p> <p><i>Aneksi 1.1.1: Statuti i Universitetit</i>  <i>Aneks: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 23)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga takimet me përfaqësuesit e sekretarisë mësimore konstatojmë se, sekretaria mësimore regjistron, hedh të dhëna, ruan dhe harton statistika vjetore për studentët e programit “Asistent Menaxher”, në përmbushje të detyrave të përcaktuara nga Rregullorja e sekretarisë mësimore. Çdo student i regjistruar është i pajisur me numër matrikullimi. Sekretaria disponon dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e shkollës së mesme, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit etj. Nga të dhënat për sekretarinë mësimore si dhe nga vizita në institucion, konstatoam se për këtë program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në vitin akademik 2018 -2019 ishin regjistruar 47 studentë, nuk ka pasur studentë të çregjistruar apo të transferuar;</li> <li>- Në vitin akademik 2019 -2020 ishin regjistruar 45 studentë, ka pasur një student të çregjistruar, nuk ka pasur studentë të transferuar, janë diplomuar 15</li> </ul>

	<p>studentë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në vitin akademik 2020 -2021 ishin regjistruar 41 studentë, ka pasur dy studentë të çregjistruar, nuk ka pasur studentë të transferuar, janë diplomuar 23 studentë. Për këtë vit akademik ka një student përsëritës viti i parë dhe 7 studentë përsëritës viti i dytë.</li> <li>- Në vitin akademik 2021 -2022 janë regjistruar 43 studentë.</li> </ul> <p>Në analizën vjetore të Departamentit të Menaxhimit, pjesë janë edhe statistikat për programin e studimit “Asistent Menaxher”, që përfshijnë notën mesatare, numrin e të diplomuarve. Këto statistika krahasohen me vitin para ardhës për të parë ecurinë. Për studentët e programit “Asistent Menaxher” për vitin akademik 2019 -2020 është konkluduar rënie e kalueshmërisë nga 77% në vitin e parë në 34% në vitin e dytë, duke sjell si pasojë një numër të ulët të diplomuarish. Gjithashtu për këta studentë është konstatuar një notë mesatare e ulët. Bazuar në të dhënat e raportuara, nga studentët e regjistruar në këtë program studimi për vitet akademike 2018-2019 dhe 2019 -2020, janë diplomuar në total rreth 41% e studentëve të regjistruar.</p> <p><i><u>GVI rekomandon</u> që Departamenti i Menaxhimit të bëjë një analizë më të detajuar të faktorëve që kanë sjell rënien e madhe në kalueshmërinë e studentëve. Në vitin e dytë të studimit, zhvillohen kryesisht lëndë karakterizuese të këtij programi studimi dhe pritët një performancë më e mirë se në lëndët që zhvillohen në vitin parë, që janë lëndë bazë.</i></p> <p><i>Aneksi I.10: Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Aneksi III. 02: DM Raportet vjetore</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatoam se, sekretaria mësimore ka hartuar evidenca të detajuara mbi studentët e programit të studimit “Asistent Menaxher”. Këto të dhëna përmbajnë pranimet për çdo vit akademik, notën mesatare në hyrje, kalueshmërinë, numrin e të diplomuarve, notën mesatare. Institucioni ka hartuar Rregullore për ruajtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 38, pika 1, e ligjit nr. 80/2015, si dhe në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe ligjin për arkivat. Për këtë program</p>

	<p>studimi mungojnë të dhënat për punësimin e studentëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon Departamentin e Menaxhimit në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alunmit, të ndjekë punësimin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi.</i></p> <p><i>Aneksi V.02: Të dhëna sekretaria mësimore</i></p> <p><i>Aneksi I.9: Rregullore e ruajtjes së të dhënave</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të administruar si dhe gjatë vizitës në institucion konstatuam se, sistemi i brendshëm i teknologjisë së informacionit ESSE3, që zbatohet në Univesitetin “Fan S. Noli”, është i sigurtë, funksional, lehtësisht i aksesueshëm nga studentët, pedagogët dhe stafi administrativ. Në funksion të përdorimit, të këtij sistemi është ndërtuar manuali i përdorimit. Në sistemin online, studentët mund të kryejnë procesin e regjistrimit për provim, të marrin gjithë informacion për ecurinë e vlerësimit të vazhdueshmëm gjatë vitit të shprehur me pikë dhe notë, si dhe provimin përfundimtar. Të dhënat për studentët dhe stafin i nënshtrohen të gjitha parashikimeve të ligjit nr. nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.</p> <p><i>Aneksi: Tabela përbledhëse (tabela nr. 17)</i></p> <p><i>Aneksi I.6: Manual i sistemit ESSE3</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Nga të dhënat e administruara konstatohet se, Departamenti i Menaxhimit harton raportin vjetor, bazuar në të dhënat e administruara nga rregjistrat që merren nga sekretaria mësimore, të dhëna nga zyra e Karrierës dhe Alunmit për punësimin, si dhe të dhëna që vijnë nga NJSBC –ja. Në raportet vjetore për këtë program studimi janë konstatuar probleme me kalueshmërinë e ulët dhe notën e ulët mesatare. Janë përcaktuar masa që duhet të ndërmerren të tilla si anketimi periodik i studentëve për të kuptuar sa i asimilueshëm dhe i vlefshëm është materiali, format e mësimdhënies të jenë më praktike dhe ekspoloruese.</p> <p><i>Aneks V.02: Të dhëna sekretaria mësimore</i></p> <p><i>Aneks V.03: QKA</i></p> <p><i>Ankes III.02: DM raporte vjetore</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	



**Standardi V.4**


**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së vetëvlerësimit, rezulton se Universiteti “Fan S. Noli” ka të sanksionuar në aktet e veta rregullatore angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse, në përputhje kjo edhe me legjislacionin e fushës. Studentët janë përfshirë në:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Senatin akademik. Sipas nenit 17, pika 5, e statutit, në Senatin Akademik të Universitetit “Fan S. Noli” bëjnë pjesë dhe studentë në masën dhjetë përqind të numrit të anëtarëve të senatit. Përfaqësuesit e studentëve zgjidhen sipas përcaktimeve të nenit 37, pika 4, e ligjit nr. 80/2015;</li><li>- Këshillin e etikës. Bazuar në nenin 29, pika 4, e Statutit, nga shtatë anëtarët e Këshillit të Etikës, një është përfaqësues i studentëve me mesatare mbi 8.5, i zgjedhur mbi bazën e vetëkandidimit nga Senati Akademik;</li><li>- Në njësinë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, një përfaqësues është student. Neni 84, pika 2 e Statutit si dhe neni 11 pika 3 e Rregullores të FE;</li></ul> <p>Një prej anëtarëve të GVB është përfaqësues i studentëve të programit “Asistent Menaxher”. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në Këshillin e Studentëve, i cili promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të univesitetit.</p> <p><i>Aneksi 1.1.1: Statuti i Universitetit</i> <i>Aneksi 1.27: Rregullore e FE</i> <i>Aneksi 1.17: Rregullorja e këshillit studentor</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin	<p>Përfshirja e përfaqësuese të studentëve në vendim marrje, garantohet nga Statuti i universitetit. Kontributi i studentëve është i rëndësishëm për përmirësimin e programit të studimit “Asistent Menaxher”. Departamenti i Menaxhimit, mbështet në anketimin periodik të studentëve për të kuptuar sesa i asimilueshëm dhe i vlefshëm është</p>

<p>akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>materiali i përdorur për çdo disiplinë.</p> <p><i>Aneksi III.02: DM raportet vjetore</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ky është akreditimi i parë për këtë program studimi. Nga dokumentacioni i administruar konstatojmë se, ngarkesa mësimore e studentëve, është në përputhje me pikën 2.1 të VKM nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programit të studimit ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”, e ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VMK nr. 185, datë 25.03.2021:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- programi i studimit “Asistent Menaxher”, është i organizuar në dy vite akademike, ka në total 120 kredite nga 60 kredite për çdo vitë akademik, sipas përcaktimeve të nenit 60 të Rregullores të FE dhe Rregullores të programit të studimit;</li> <li>- Zhvillimi i mësimit është përcaktuar në nenin 70, të Rregullores të FE. Ngarkesa për student është jo më shumë se 25 orë mësimi në javë, me kohëzgjatje 50 minuta dhe pushim 10 minuta;</li> <li>- Programi ka në total 1500 orë në vitin e parë të studimit, nga të cilat 660 orë zhvillihen në auditor dhe 840 orë jashtë auditorit. Në vitin e dytë të studimit në total janë 1500 orë nga të cilat 540 orë në auditor dhe 960 orë jashtë auditorit. Për të dy vitet akademike, orët jashtë auditorit zënë respektivisht 56% dhe 64% të totalit të orëve;</li> <li>- Programi ka për dy vite akademike, orë totale në auditor 1158, nga të cilat 657 orë leksione, 501 orë seminare, 125 orë praktika profesionale dhe 150 orë diploma.</li> </ul> <p>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se, institucioni respekton aktet ligjore dhe nënligjore për transferimin e studimeve. Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i moduleve është i mundur për këtë program studimi. Neni 86, 87, 88, 89 dhe 90 e Rregullores të FE, japin bazën ligjore dhe procedurat që duhen të ndiqen nga studentët me qëllim transferimin e krediteve. Për këtë program studimi, nuk ka studentë të transferuar.</p> <p><i>Aneksi II.02: VKM nr 41, datë 24.01.2018</i></p> <p><i>Aneksi I.25: Programet lëndore</i></p> <p><i>Aneksi II.01: Plani mësimor</i></p>

	<p><i>Aneksi I.27: Rregullore e FE</i></p> <p><i>Aneksi I.44: Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në nenin 103, të Rregullores të FE, parashikohet rishikim periodik i programit të studimit bazuar në relacionet e sjella nga përgjegjësit e departamentit. Dekani i Fakultetit organizon procesin e tërheqjes së opinioneve të studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha modulet. Për programin e studimit “Asistent Menaxher”, ka pasur ndryshime në planin mësimor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2020 -2021, ndryshim të ngarkesës në auditor për modulën “E -business dhe komunikim elektronik”, nga ngarkesa 45 orë leksioni - 15 orë seminari në javë, në 30 orë leksioni - 30 orë seminari në javë;</li> <li>- Për vitin akademik 2021 -2022, lënda: <ul style="list-style-type: none"> <li>“Matematikë diskrete”, nga 5 ECTS bëhet 4 ECTS, ngarkesa nga 30 orë leksioni – 30 orë seminari, bëhet 15 orë leksioni -30 orë seminari;</li> <li>“Anglisht” nga 5 ECTS bëhet 4 ECTS, ngarkesa nga 30 orë leksioni – 30 orë seminari, bëhet 45 orë seminari;</li> <li>“Excel” nga 5 ECTS bëhet 6 ECTS, ngarkesa nga 36 orë leksioni – 24 orë seminari, 30 orë leksioni – 30 orë seminari;</li> <li>“Gjuha e huaj Frëngjisht” nga 5 ECTS bëhet 4 ECTS, ngarkesa nga 30 orë leksioni – 30 orë seminari, bëhet 24 orë leksioni – 24 orë seminari;</li> <li>“Kontabilitet”, nga 5 ECTS bëhet 6 ECTS;</li> <li>“Psikologji/ Sociologji” nga 5 ECTS bëhet 6 ECTS;</li> <li>“E -business dhe komunikim elektronik” nga 5 ECTS bëhet 6 ECTS;</li> <li>“Praktika mësimore” nga 6 ECTS bëhet 5 ECTS;</li> <li>“Marëdhënie me publikun” nga tipi i veprimtarisë B, kalon në tipin e veprimtarisë D.</li> </ul> </li> </ul> <p>Studentët janë një element i rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Institucioni në mënyrë periodike realizon pyetesorë me studentët për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit, në përputhje me nenin 103, pika 3, të ligjit nr. 80/2015. NJSBC -ja, evidenton problemet lidhur</p>

	<p>me mësimin, organizimin dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, në fund të çdo semestri apo para sezonimit të provime, sipas nenit 24, pika 3, të Rregullores të Drejtorisë së Kurikulave. Në pyetësorin e studentëve organizuar nga FE, studentët pyeten nësë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Janë të informuar në fillim të vitit akademik për moduet, kreditet, metodën e vlerësimit, detyrat që do të zhvillojnë gjatë vitit;</li> <li>- Për pjesëmarrjen në leksione dhe seminare;</li> <li>- Vlerësimin e përformacës të pedagogut;</li> <li>- A i gjykojnë të rëndësishme detyrat e kursit gjatë semestrit;</li> <li>- Nëse duan që të ndryshojnë diçka.</li> </ul> <p>Konstatojmë se, në rishikimin e planit mësimor, është marrë në konsideratë mendimi i studentëve.</p> <p><i>Aneksi 1.5: Rregullore e drejtorisë së kurrikulave, NJSBC –së dhe Kërkimit shkencor</i></p> <p><i>Aneksi 1.27: Rregullore e FE</i></p> <p><i>Aneksi III.01: Model pyetësori studentor</i></p> <p><i>Aneks II.11: Ndryshime në planin Mësimor</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se studentët e këtij programi studimi, nuk kishin pakënaqësi në lidhje me vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit dhe vlerësimin përfundimtar. Pyetësorët e studentëve që zhvillohen në fund të çdo semestri, u japin mundësi studentëve që të shprehen për problematika të hasura në lëndë/ module të ndryshme të programit të studimit. Ankimi për shkelje të rregullave proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose për mos dakortësi në lidhje me notën, është parashikuar në nenin 83, të Rregullores të FE. Nga takimi me studentët rezultoi se ata kishin informacion për këtë të drejtë të tyre dhe për procedurën.</p> <p><i>Aneks 1.27 Rregullore e FE</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



**Standardi V.5**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion konstatohet se, Univesiteti “Fan S. Noli” ka ngritur një sistem të organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. bazuar në nenin 112, të Rregullores të FE. Informacioni është disponibël:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Në faqen zyrtare të universitetit;</li><li>- Në sekretari, në formë të printuar;</li><li>- Në sistemin ESSE3;</li><li>- I shpallur në mjediset e FE;</li><li>- Në faqen e FE në rrjetet sociale;</li></ul> <p>Qendra e karrierës dhe alumnit, për çdo vit akademik, bën publik planin e veprimtarisë së saj. Kjo qendër ofron shërbim për studentët gjatë gjithë vitit akademik, zhvillon panairin e karrierës, trajnime të ndryshme, ofron asistencë për kërkimin e një vendi pune.</p> <p><i>Aneksi 1. 27: Rregullore e FE</i> <i>Aneks V.03: QKA</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumnit, e ka pjesë të detyrave të saj funksionale, zhvillimin e seancave informuese me studentët e viteve të para, zhvillon takime periodike me Këshillin Studentor, ofron asistencë të vazhdueshme studentëve për realizimin e apikimeve për shkolla verore, intership, punë. Programi i studimit “Asistent Menaxher”, ka koordinatort programi, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Koordinatori mban kontakt të vazhdueshëm me studentët dhe informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse për ecurinë e zbatimit të programit të studimit dhe praktikave profesionale, në përputhje me nenin 9 të Rregullores të Departamentit të Menaxhimit.</p>


	<p><i>Aneks V.03: QKA</i>  <i>Aneks II.09: Koordinator i programit të studimit</i>  <i>Aneks I.41: Rregullatore e DM</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita në institucion në Qendrën e Karrierës dhe e Alumnit, konstatum se ishte vetëm një person i punësuar për të gjithë Universitetin “Fan S. Noli”. Kjo bën që performanca e kësaj zyre të mos jetë shumë e mirë, pavarësisht planit të detajuar të veprimitarisë për çdo vitë akademik. Në lidhje me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor dhe praktikën profesionale, studentët janë të orjentuara nga koordinatori i programit të studimit, i cili mban kontakte të vazhdueshme me studentët dhe drejtuesit e departamentit.</p> <p><i>Aneks V.03: QKA</i>  <i>Aneks II.09: Koordinator i programit të studimit</i>  <i>Aneks I.41: Rregullatore e DM</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e administruar, programi i studimit ka në total 38 të diplomuar. Nuk ka të dhëna për punësimin e të diplomuave.</p> <p><i>GVJ rekomandon që qendra e karrierës dhe alumnit, të mbledh të dhëna për punësimin e studentëve të këtij programi studimi.</i></p> <p><i>Aneks V.03: QKA</i>  <i>Aneks: Tabela përmbledhëse (tabela nr. 23)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit Diplomë Profesionale “Asistent Menaxher”

### **a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit “Asistent Menaxher”, ofrohet për të plotësuar kërkesat e tregut rajonal të punës për specialist të aftë dhe kompetentë që do të kryejnë funksionet e Asistent Menaxherit. Programi është relativisht i rrallë në gamën e programeve profesionale të studimit, duke krijuar mundësi të mira punësimi për studentët;
2. Programi i studimit “Asistent Menaxher”, përmban shumë lëndë karakterizuese, të ndryshme nga programi i studimit “Bachelor”, që ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit i Universitetit “Fan S. Noli”, duke i pajisur studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike në përputhje me kërkesat e tregut të punës;
3. Në përputhje me detyrat që duhet të kryejë një “Asistent Menaxher”, programi i studimit i pajis studentët me njohuri të nevojshme për të realizuar në praktikë një shumëllojshmëri detyrash komplekse administrative të ngarkuara nga menaxheri, të tilla si:
  - b. Administrimi i personelit;
  - c. Përdorimi i programeve kompjuterike për planifikimin, organizimin, koordinimin e punës;
  - d. Mbajtja e korendosjeve zyrtare, hartimi i raporteve;
4. Programi i studimit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë gjuhëve të huaja. Programi ofron dy gjuhë të huaja, gjuhën “Angleze” dhe “Frënge”. Përfshirja e tyre i ndihmon studentët jo vetëm që të asimilojnë të gjithë literaturën në dispozicion të këtij programi studimi, por zhvillimi i njohurive të këtyre gjuhëve të huaja, krijon një avantazh në tregun e punës. Rajoni i Korçës, frekuentohet nga turistë të huaj, gjatë gjithë vitit. Njohja ose perfeksionimi i gjuhëve të huaja, lehtëson komunikimin;
5. Përfshirja në programin e studimit të lëndë të tilla si “Sociologji”, “Psikologji”, “Marrëdhënie me konsumtorin”, është shumë e rëndësishme duke i dhënë një avantazh në vendin e punës, pasi ndihmojnë në marrëdhëniet e asistent menaxherit me të punësuarit e kompanisë dhe klientët, ndihmojnë në zgjidhjen e situatave në vendin e punës;
6. Programi i studimit “Asistent Menaxher”, ka një nivel të lartë të mbulimit me staf efektiv të Univesitetit “Fan S. Noli”, si dhe një stafi mbështetës të kualifikuar, të angazhuar dhe të motivuar;
7. Univesiteti “Fan S. Noli”, ka një sistem efektiv informatik ESSE3, si platformë komunikimi dhe shkëmbimi informacioni të brendshëm;
8. Programi i studimit “Asistent Menaxher” ka një numër i lartë, studentësh i regjistruar;




## **b. Pika të dobta:**

1. Nuk ka studime periodike të tregut të punës për profesionin “Asistent Menaxher”;
2. Nuk ka të dhëna për punësimin e studentëve të diplomuar në programin “Asistent Menaxher”;
3. Referuar planit mësimor të studimit “Asistent menaxher”, lloji i orëve mësimore që zhvillohet në kuadër të këtij programi është vetëm leksione dhe seminare, nuk ka orë laboratorit të përcaktuara;

## **Rekomandime**

1. Rekomandojmë që të zhvillohen studime periodike të tregut të punës dhe të krijohet një bazë të dhënash për punësimin e studentëve të diplomuar. Studimi i tregut para hapjes së programit të studimit “Asistent Manaxher”, është bazuar në anketimin e 250 bizneseve të qarkut të Korçës, nga të cilët rreth gjysma e bizneseve rezultuan të interesuar për të pasur si pjesë përbërëse e tyre një asistent menaxher;
2. Rekomandojmë që Departamenti i Menaxhimit, në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumnit, të evidentojë shkaqet e mungesës së punësimit të studentëve pas diplomimit, pasi mungojnë të dhënat e punësimit jo vetëm në përputhje me diplomën “Asistent Menaxher” por edhe për punësimin e studentëve jo në përputhje me diplomën;
3. Rekomandojmë që orët e laboratorit që zhvillohen gjatë vitit, të reflektohen dhe në planin mësimor;
4. Rekomandojmë që të paktën për lëndët karakterizuese, të konsiderohet mundësia e botimit/ përdorimit të teksteve mësimore në gjuhën shqipe, në përputhje me udhëzimet e Senatit akademik të Universitetit “Fan S. Noli”;
5. Rekomandojmë që Departamenti i Menaxhimit të bëjë një analizë më të detajuar të faktorëve që kanë sjell numër të ulët të të diplomuarve. Rënia e madhe në kalueshmërinë e studentëve për vitin akademik 2019 -2020 nga 77% në vitin e parë në 34% në vitin e dytë, kërkon një analizë më të detajuar. Në vitin e dytë të studimit, zhvillohen kryesisht lëndë karakterizuese të këtij programi studimi dhe pritet një performancë më e mirë në krahasim me lëndët që zhvillohen në vitin parë, që janë kryesisht lëndë bazë;
6. Në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të programit të studimit, konkretisht për detyrën e mbajtjes të korenspondencës zyrtare dhe hartimi i raporteve, që një asistent menaxher do të kryejë, rekomandojmë të konsiderohet përfshirja në programin e studimit e lëndës “Kulturë gjuhe shqipe”;






## Conclusions of the evaluation of the study program Professional Diploma "Assistant Manager"

### **a. Strong points and affirmations:**

1. Study program "Assistant Manager", is offered to fulfill regional market demands of work for skilled and competent specialists who will perform the functions of Assistant Manager. The program is relatively rare in the range of professional study programs, creating good employment opportunities for students;
2. Study program "Assistant Manager", includes many characteristic subjects, in difference of study program "Bachelor" offered by Management Department of University "Fan S. Noli", equipping students with theoretical knowledge and practical skills in accordance with the demands of the labor market;
3. Likewise the tasks an "Assistant Manager" must perform, the study program provides students with necessary knowledge to execute a variety of complex administrative tasks assigned by the manager, such as:
  - a. Staff administration;
  - b. Use of software's for planning, organizing, coordinating work;
  - c. Maintaining official correspondence, drafting reports;
4. Study program has paid special attention to foreign languages. The program offers two foreign languages, English and French. Their inclusion helps students not only to assimilate all the literature available to this study program, but also the development of knowledge of these foreign languages, creates an advantage in the labor market. The Korça region is frequented by foreign tourists throughout the year. Knowledge or perfection of foreign languages, facilitates communication;
5. Including in the study program subjects like "Sociology", " Psychology", " Costumer Relationship", is really important by giving advantage in the workplace, as they assist in the assistant manager's relationship with the company's employees and clients, assist in resolving situations in the workplace;
6. Study program "Assistant Manager" has a high level of coverage with effective staff of the University "Fan S.Noli", as well as a qualified, committed and motivated staff;
7. University "Fan S.Noli" has an effective information system ESSE3, as a platform for communication and exchange of internal information;
8. Study program "Assistant Manager" has a high number of registered students;

### **b. Weak points:**

1. There are no periodic labor market studies for the profession of "Assistant Manager";
2. There is no data on the employment of graduated students in the program "Assistant Manager";




3. According to the curriculum of the study “Assistant Manager”, the type of teaching hours that take place within this program, are only lectures and seminars, there are no defined laboratory classes;

**Recommendations:**

1. We recommend that periodic labor market studies should be conducted and that a database for the employment of graduated students should be created. Market study before the opening of the study program “Assistant Manager”, is based on a survey of 250 businesses in the Korça Region, of which about half of the businesses were interested in having an assistant manager as their integral part;
2. We recommend the Management Department in cooperation with the Career and Alumni Center to identify the causes of lack of students employment after graduation, as employment data are missing not only in accordance with the diploma “Assistant Manager” but also for the employment of students not in accordance with this diploma;
3. We recommend that the laboratory classes that take place during the year, should be reflected in the teaching curriculum;
4. We recommend that at least for the characteristic subjects, to consider the possibility of publishing/using textbooks in Albanian language, in accordance with the instructions of the Academic Senate of the University “Fan S. Noli”;
5. We recommend the Department of Management to make a more detailed analysis of the factors that have led to a low number of graduates. The large decrease in student attendance for the academic year 2019-2020 from 77% in the first year to 34% in the second year, requires a more detailed analysis. In the second year, mainly characteristic subjects of this study program are developed and a better performance is expected compared to the subjects developed in the first year, which are mainly basic subjects;
6. In order to further improve the study program, more specifically the task of maintaining official correspondence and drafting reports, that an assistant will perform, we recommend to consider the inclusion in the study program of the course “Albanian Language Culture”;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER				X



<b>PROFESIONAL</b>				
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

